

CEE

bankwatch
network



“Le të flasim për Fondet IPA II”

Udhëzues për Organizatat e
Shoqërisë Civile



Ky publikim u përgatit nga Ana Colovic Lesoska dhe Markus Trilling nga CEE Bankwatch Network.

Për rastet studimore nga vendet e BE-së kanë kontribuar:


Teodóra Dönsz-Kovács (MTVSZ, Hungari)
Roman Havlíček (CEPA, Sllovaki)
Ivaylo Hlebarov (Za zemiata, Bullgari)

Për rastet studimore nga vendet e Ballkanit kanë kontribuar:

Elona Saro (EDEN Center, Shqipëri)
Ana Colovic Lesoska (Eko-svest, Maqedoni)
Marijan Galović (Zelena Akcija, Croaci)
Natasa Đereg (CEKOR, Serbi)

Dizenjimi dhe paraqitja

Kalina Denkovska



Ky publikim u publikua falë ndihmës financiare të Bashkimit Evropian dhe International Visegrad Fund. Përmbajtja e këtij publikimi është tërësisht përgjegjësia e CEE Bankwatch Network dhe në asnjë rast nuk mund të interpretohet si këndvështrim i Bashkimit Evropian dhe International Visegrad Fund.

Bankwatch është gjithashtu mirënjohësdonorëve pëmbështetjen e vazhdueshme: Charles Stewart Mott Foundation, European Climate Foundation, International Visegrad Fund, Sigrid Rausing Trust



Përmbajtja

Përmbajtja	4
Hyrje.....	5
Asistenca e paraaderimit e BE-së.....	6
IPA dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare.....	14
1. Hungaria.....	16
2. Bullgaria.....	21
Eksperienca e OJQ-ve nga programimi i fondeve të BE-së në Bullgari për periudhën 2007-2013... 	21
3. Sllovakia.....	27
Vlerësimi i procesit të programimit të fondeve të BE-së për periudhën 2007-2013 nën këndvështrimin e pjesëmarrjes së OJQ-ve.....	27
Pëmbledhje e pjesëmarrjes së publikut në vendet e Ballkanit perëndimor në IPA.....	31
Shqipëria.....	31
Kroacia.....	34
Maqedonia.....	38
Serbia.....	40
Mundësitë për përfshirje në programimin e IPA-s në nivel kombëtar	43
Rekomandime.....	44
Lidhje të dobishme	47



Hyrje

Ky udhëzues është një version i përditësuar i udhëzuesit “Le të flasim për Fondet IPA” publikuar në vitin 2011. Synimi i këtij udhëzuesi është që të orientojë dhe të mbështesë OJQ-të dhe palët e interesit në Ballkanin Perëndimor të interesuar apo të përfshirë në ciklin e programimit për financimet e paraaderimit, duke i inkurajuar ata që të eksplorojnë çdo mundësi për pjesmarrjen e publikut në këtë proces.

Pas një hyrjeje të shkurtër në procesin formal të programimit dhe Instrumentin e ri IPA II, do të ilustrohen disa raste studimore të shembujve pozitivë dhe negativë nga eksperiencat në proceset e programimit në vende të ndryshme, ndjekur kjo nga një pasqyrim i mundësive për pjesmarrjen e publikut në financimet e paraaderimit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në fund udhëzuesi do të ofrojë informacion mbi hapat e mëtejshëm dhe do të sjellë disa rekomandime për një program pjesmarrës dhe transparent të fondeve të paraaderimit.



Asistenca e paraaderimit e BE-së

Bashkimi European siguron ndihmë financiare paraaderuese për **vendet kandidate (aktualisht: Islanda, Serbia, Mali i Zi, Turqia dhe Maqedonia)** dhe vendeve **potenciale kandidate (Shqipëria, Bosnje-Herzegovina, dhe Kosova** nën Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999). Kjo mbështetje financiare është në dispozicion të përfituesve individual dhe shumë-palësh. Asistenca është e ideuar për të ndihmuar këto vende për të ndërruar reformat e nevojshme politike, ekonomike dhe institucionale dhe për ti sjellë këto vende në linjë me standartet e BE-së.

Reformat e nevojshme për anëtarësimin në BE gjithashtu kanë për qëllim të përmirësojnë jetën e qytetarëve në vendet përfituese. Një nga qëllimet kryesore të asistencës është mbështetja për reformat politike, veçanërisht rritja e kapaciteteve, forcimi i ligjit, të drejtat e njeriut, mbrojtjen e minoriteteve dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

“Një ekonomi tregu funksionale” shihet si një parakusht për tu pranuar në BE. Për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së, asistenca është e ideuar për të mbështetur reformat ekonomike, të cilat duhet të udhëheqin drejt një “ritjeje të shpejtë” dhe një perspektivë më të mirë punësimi.

Asistenca gjithashtu synon të përmirësojë edhe cilësinë e jetesës në vendet e Bashkimit European, si në vendet kandidate ashtu edhe në ato

kandidate potenciale; të gjitha këto shtete duhet që gradualisht të adoptojnë dhe zbatojnë rregullat e BE-së, për shembull në lidhje me **mbrojtjen e mjedisit dhe luftën kundër krimit, drogave dhe imigracionit të paligjshëm**. Gjithashtu, asistenca e paraaderimit nxit bashkëpunimin rajonal dhe **ndihmon në zhvillimin e qëndrueshëm** dhe uljen e varfërisë.

Instrumenti për Asistencën e Paraaderimit (IPA) u krijua në vitin 2006 si një element kyç i strategjisë për asistencën e para-aderimit të Bashkimit Evropian për periudhën 2007-2013. Instrumenti do të vazhdojë të funksionojë edhe në periudhën në vazhdim 2014-2020 nëpërmjet zbatimit të Rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi Instrumentin e Para-aderimit (IPA II).

Qëllimi i Fondeve IPA është të mbështesë vendet në tranzicionin e tyre të kalimit nga vende kandidate potenciale në vende kandidate dhe më pas në vende anëtare të BE-së.

IPA do të ndihmojë këto vende që të plotësojnë kriteret e pranimit (plotësimin e kriterit politik, ekonomik dhe legjislativ, ndërtimin e kapaciteteve administrative dhe juridike) dhe gjithashtu në përgatitjen për programimin e menaxhimit dhe zbatimit të fondeve të zhvillimit Kohezional, Strukturor dhe Rural pas aderimit në BE.

Për të përmbushur qëllimet e mësipërme, në periudhën 2007-2013

IPA konsistonte në pesë komponentë nën të cilët u mundësua mbështetja financiare. Në periudhën e ardhshme (2014-2020), komponentët do të referohen si **fushat e politikave**.

Tabela 1. Tregon titujt e komponentëve nën periudhën 2007-2013 (IPA I), titujt e rinj sipas periudhës 2014-2020 IPA II dhe mbulimin e tyre sipas sektorëve. Siç shihet edhe në tabelën më poshtë, të gjithë komponentët gjetën vendin e tyre tek fushat e politikave të propozuara. Asistenca për tranzicionin dhe komponenti për ngritjen e institucioneve (IPA 1), i njohur si Ngritja e Kapaciteteve dhe Proçesi I Tranzicionit, në periudhën e re është e lidhur me *acquis*¹ dhe ngritjen e institucioneve në rastin e vendeve candidate, por kryen edhe rolin e një komponenti i cili mbulon të gjithë komponentët për vendet Kandidate Potencialë. Komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar (IPA-II) mund të aplikohet për rajonet fqinjë ndërmjet të gjithë vendeve përfituese dhe gjithashtu edhe ndërmjet vendeve candidate dhe anëtare të BE-së. Në komponentët e Zhvillimit Rajonal, Zhvillimit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit Rural (IPA 3, 4 dhe 5), të njohur ndryshe si Komponentë të Zhvillimit Rajonal; Punësimit, Politikave, Sociale dhe Zhvillimit të Burimeve Njerëzore; Agrikulturë dhe Zhvillim Rural nën të cilat asistenca për vendet candidate të vlerësuara për menaxhimin e të gjithë asistencës në

¹ *Acquis communautaire* është një term Francez që i referohet të gjithë ligjeve të Komunitetit Europian, duke përfshirë këtu objektivat e BE-së, rregullat, politikat dhe veçanërisht legjisllacionin primar e sekondar, praktikatat gjyqësore të cilat janë pjesë e rendit juridik të Bashkimit Europian. Këtu përfshihen gjithashtu të tërë traktatat, rregulloret, direktivat e aprovuara nga institucionet Europiane dhe vendimet e marra nga Gjykata Europiane e drejtësisë. *Acquis* është dinamik dhe në zhvillim të vazhdueshëm. Të gjithë shtetet anëtare janë të detyruara të zbatojnë *acquis communautaire*.

një sistem të decentralizuar implementimi është dhënë në mënyrë të tillë që të përgatisë vendet për të menaxhuar fondet e BE-së për Zhvillimin Kohezional, Zhvillimit Struktural dhe atë Zhvillimin Rural.

Asistenca e fondeve IPA mund të përdoret edhe për të mbuluar kostot e aktiviteteve lidhur me administrimin dhe menaxhimin, ndjekjen, kontrollin, auditimin dhe vlerësimin e gjithashtu në raste të veçanta edhe për takime, informacion, reklama, asistencë teknike dhe mbështetje për administratën për arsye të veprimeve menaxhuar nga Delegacionet.

IPA vepron në vendet candidate dhe potenciale candidate, sipas anekseve të rregullore të IPA-s. Për financim në periudhën e parë (IPA I), akses për të gjithë komponentët kishin vetëm vendet candidate, ndërkohë që vendet candidate potenciale mund të përdornin vetëm komponentët 1 dhe 2. Instrumenti i ri IPA II është më i thjeshtuar dhe më fleksibël. Të gjitha shtetet IPA pavarësisht statusit të tyre, mund të marrin asistencë financiare në çdo fushë. Thjeshtësimi dhe fleksibiliteti i instrumentit të ri vjen si rezultat i modifikimit të instrumentit IPA II.

Instrumenti i ri parashikon se vendimet strategjike mbi shpërndarjen e asistencës do të kryhen mbi bazën e dokumentave gjithpërfshirëse në nivel vendi dhe strategjive të shumë shteteve që mbulojnë periudhën 2014-2020. Këto dokumenta do të rishikohen një herë në mes të periudhës së interesuar, duke zëvendësuar kështu sistemin e deri më tanishëm e planifikimit indikativ për 3 vjet dhe rishikimit për çdo vit.

Thjeshtësim tjetër duhet të vijë si pasojë e përqasjes bazuar në sektorë për shpërndarjen e asistencës për

këta sektorë. Nevojat e vendeve përfituese do të jenë pika e fillimit për të përcaktuar sektorët/fushat politike.

Emri i komponentit (sipas IPA I 2007-2013)	Emri i fushave politike (sipas IPA II 2014-2020)	Sektorët e mbuluar
Asistencë për Tranzicionin dhe Ngritje Institucionesh (komponenti IPA 1)	Proçesi i Tranzicionit dhe Ngritje kapacitetesh (PTNK)	Administrata Publike Re-forma Financa Publike Qeverisja Drejtësia dhe çështje të brendshme Të drejtat e Njeriut dhe Minoritetet
Zhvillimi Rajonal (komponenti IPA 3)	Zhvillimi Rajonal	Transport Energji Mjedis Zhvillimi i Sektorit Privat Inovacioni dhe Konkureshmëria
Zhvillimi i Burimeve Njerëzore (komponenti IPA)	Punësimi Politika Sociale dhe Zhvillim i Burimeve Njerëzore	Edukimi dhe Zhvillim il Burimeve Njerëzore Punësimi dhe Tregu i Punës Politika Sociale
Zhvillimi Rural (komponenti IPA 5)	Agrikultura dhe Zhvillimi Rural	Agrikultura dhe Zhvillimi Rural
Bashkëpunimi ndër kufitar (komponenti IPA 2)	Bashkëpunim rajonal dhe territorial	Bashkëpunim Rajonal në sektorët e mësipërm Bashkëpunim territorial.

Tabela 1. Titujt e komponentëve IPA dhe fushave politike në lidhje me periudhat IPA I dhe II, mbulimi sipas sektorëve

Rregullorja IPA është dokumenti kryesor që përcakton instrumentin. Teksti i saj është propozuar nga Komisioni Evropian dhe Rregullorja është pranuar nga Parlamenti Evropian. Për një zbatim sa më praktik të saj, Komisioni Evropian ka ahrtuar **Rregullore të Përbashkët për Zbatim**. Për qëllimin e planifikimit strategjik të Fondeve IPA në çdo shtet përfitues, një **Kornizë e Përbashkët Strategjike** (KPS) është hartuar nga Komisioni Evropian. Më parë ky dokument ka qënë i njohur me emrin Korniza Financiare Indikative Shumëvjeçare. KPS përkthen prioritetet politike në aksione kyçe që mund të përfitojnë asistencë nën rregulloren IPA.

Në nivel kombëtar, Komisioni Evropian në bashkëpunim me çdo shtet përfitues përcakton një **Dokument Strategjik Kombëtar** për të gjithë periudhën financiare. Ky dokument përcakton fushat e politikës që do të përfitojnë asistencë financiare, duke reflektuar nevojat dhe prioritetet në përputhje me objektivat IPA, Korniza Strategjike e Përbashkët dhe strategjitë kombëtare. Dokumenti Strategjik Kombëtar përfshin shpërndarjen indicative financiare për çdo fushë, gjithashtu lejon adresimin e nevojave emergjente dhe përfshin stimuj për të rritur performancën e vendeve përfituese. Korniza Strategjike e Përbashkët gjithashtu cakton kriteret për alokimet financiare për çdo shtet dhe pajis me udhëzime për sa i përket menaxhimit dhe zbatimit.

Në nivel kombëtar shteti përfitues zhvillon më tej programin e tij kombëtar në fusha të ndryshme dhe zbaton programin në periudhën e dytë të programimit. Grafiku 1 më poshtë tregon piramidën e programimit për IPA II. Përveç fondeve të para

aderimit, Bashkimi Evropian i mundëson financim shteteve të tjera jashtë BE-së nëpërmjet këtyre instrumentave: Instrumenti për Zhvillim dhe Bashkëpunim ("DCI"), Instrumenti Evropian për Demokraci dhe Të Drejtat e Njeriut ("EIDHR"), Instrumenti i Fqinjësisë Evropiane ("ENI"), Instrumenti për Qëndrueshmërinë ("IfS"), Instrumenti për Bashkëpunim në Sigurinë Bërthamore ("INSC"), si dhe Instrumenti i Partneritetit. ("PI"). Në mënyrë për të thjeshtuar dhe harmonizuar zbatimin e këtyre instrumentave, Komisioni Evropian propozoi një Rregullore mbi Rregullat e Përbashkëta dhe procedurat për zbatimin e Instrumentave të Bashkimit Evropian. Kjo rregullore përcakton rregullat që duhen ndjekur në zbatimin e instrumentave të sipër përmendur, llojin e financimit që do të përporet nën këtë rregullore dhe masat që mund të financohen për të mbështetur zbatimin e tyre (si psh. Përgatitja, kontrolli, auditi, vlerësimi, monitorimi, etj). Rregullat e përbashkëta dhe procedurat gjithashtu pohojnë se Komisioni Evropian do të mbajë një system të veçantë regjistrimi për instrumentat e mësipërm pësa i përket aksionit klimatik dhe shpenzimeve të biodiversitetit. Ky system bazohet tek të ashtuquajturit "shënuesit Rio" (metodologjia e OECD e integruar në menaxhimin e performancës së programeve të BE-së.) dhe duhet të ndihmojë në vlerësimin e shpenzimeve vjetore në lidhje me aksionin klimatik dhe biodiversitetin.

Paketa vjetore e zgjerimit cakton kornizën e përgjithshme strategjike për procesin e para-aderimit nën të cilin IPA duhet të

veprojë **Partneritetet e Aderimit**² dhe Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, **Progres Raportet**, **Strategjitë e prezantuara** çdo vjeshtë nga Komisioni Evropian dhe Parlamenti).

Çdo vjeshtë Komisioni pranon **“paketën e zgjerimit”** – një set dokumentash që shpjegojnë politikat mbi zgjerimin e BE-së. Paketa zakonisht përfshin një **strategji vjetore** që ofron një version të përditësuar të politikave të zgjerimit, objektivave dhe perspektivave, si dhe një **vlerësim të progresit të bërë në 12 muajt e fundit nga çdo shtet kandidat dhe potencial kandidat**. Gjithashtu publikohen edhe **raportet e progresit të detajuara**, ku Komisioni monitoron dhe vlerëson në detaje se çfarë ka arritur çdo shtet në vitin e fundit dhe fushat që kanë nevojë për përmirësim. Në vite të caktuar, paketa e zgjerimit gjithashtu përfshin edhe propozimet për Këshillin e ministrave për rishqyrtim të partneritetit Evropian dhe të Aderimit për çdo shtet që Komisioni i cakton fushat prioritare për reforma të mëtejshme.

² **Partneritete të Aderimit**, si pjesë e strategjisë së para-aderimit, perben kornizen e procesit të para-aderimit për çdo shtet kandidat. Ato përcaktojnë:

- **Fushat prioritare** në të cilat shtetet kandidate duhet të përmirësohen, sipas prioriteteve të identifikuar në opinionin e Komisionit Evropian, mbi aplikimin për të qenë pjesë e Bashkimit Evropian;
- **mbeshtetja financiare** nën një kornizë të vetme Partneritetet e Aderimit mund të rishikohen sipas progresit të arritur nga vendet kandidate.



Grafiku 1. Një piramidë që tregon procesin e programimit për IPA II

IPA në buxhetin e BE-së

Korniza financiare Shumë-vjeçare për periudhën kohore 2014 -2020 përcakton 10.38 miliardë EURO Instrumentit për Para-Aderimin³. Ky numër mbetet ndjeshëm nën propozimin fillestar të Komisionit Evropian (14.11 miliardë EURO) dhe vjen si rezultat i marrëveshjes mes shteteve anëtare për të ulur buxhetin e përgjithshëm të BE-së

Buxheti i BE-së për periudhën kohore 2014 – 2020 arrin në 960 miliardë EUR, ndarë në 5 nën kategori. Dy të tretat e buxhetit të BE-së janë caktuar për Politikën e Agrikulturës Evropiane dhe për zhvillimin e rajoneve Evropiane nëpërmjet Politikave Kohëzore. IPA është pjesë e kategorisë 4 “Global Europe”, duke përfshirë edhe instrumente politike të tjerë të jashtëm si ENI ose DCI shuma shkon në 58.7 miliardë EURO për periudhën 2014 – 2020:

(IPA)	
Instrumenti i Fqinjësisë Evropiane (ENI)	13 682.6
EIDHR	1182.5
Instrumenti i Stabilitetit (IfS)	2 075.1
Siguria (CFSP)	2 075.1
Instrumenti i Partneritetit (PI)	844.3
Instrumenti i Zhvillimit të Bashkëpunimit (DCI)	17 380.4
Ndihma Humanitare	5 877.9
Mbrojtja civile (CPFI) + ERC	128.4
EVHAC	130.1
Instrumenti për Sigurinë Bërthamore dhe bashkëpunim (INSC)	200.0
Asistencë Makro-financiare	501.0
Fond Rezervë/Garancie	1 063.1
Agjensi	136.7
Të tjera	1 036.8
Rezervë	2 000.0
Totali	58 704.0

Tabla 2. Kategoria 4 “Global Europe”

Shteti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	61.0	70.7	81.2	94.1	94.4	94.5	95.3
Bosnja & Hercegovina	62.1	74.8	89.1	105.3	107.4	107.8	108.8
Kroacia	142.2	146.0	151.2	153.5	156.5	156.1	93.5
Maqedonia	58.5	70.2	81.8	91.6	98.0	101.8	113.2
Islanda	---	---	---	---	12.0	12.0	5.8
Kosova*	68.3	184.7	106.1	67.3	68.7	68.8	71.4
Mali i Zi	31.4	32.6	34.5	33.5	34.1	35.0	34.5
Serbia	189.7	190.9	194.8	197.9	201.8	202.0	208.3
Turqia	497.2	538.7	566.4	653.7	779.9	860.2	902.9
Programi Shumë-përfutues	129.5	137.7	188.8	141.7	186.2	176.2	177.2

Tabla 3. shpenzimet IPA në periudhën 2007-2013 (në milion EURO).

*sipas Kombeve të bashkuara, Kosova është “nën Administrimin e Kombeve të Bashkuara, Misioni i Administratës së përkohshme në Kosovë (UNMIK) i themeluar në pajtimin me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit

³ Sipas konkluzioneve të Këshillit nga Korriku 2013. Miratimi final i legjislacionit MFF pritet në muajt e fundit të vjeshtës 2013. Vetëm atëherë mund të konfirmohet buxheti final i BE-së.

IPA dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare

Korniza e Investimeve e Ballkanit Perëndimor (KIBP) është mekanizmi i shkrirjes së financimit të granteve që vijnë nga Komisioni Europian dhe Shtetet Anëtare dhe huatë nga Institucione Financiare Europiane Publike (Banka Europiane e Investimeve (BRI), Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka e Zhvillimit të Këshillit Europian).

Korniza e Investimeve e Ballkanit Perëndimor, KIBP alokon grante për të mbuluar shpenzimet për asistencën teknike, subvencionet e interesit dhe investimeve direkt të kapitalit. KIBP luan një rol shumë të rëndësishëm në promovimin e projekteve të mëdha të infrastrukturës në Evropën Jug Lindore, projekte të cilat zbatohen zakonisht nga BEI dhe BERZH, si edhe nga disa institucione shumëpalëshe si psh. KfW. Projektet e propozuara për tu mbështetur duhet që të nominohen ose që të miratohen nga Koordinatori kombëtar i IPA-s i vendit përkatës. Projektet me ndikimi rajonal kanë gjithmonë precedentë kur merret vendimi mes aplikimeve

Korniza e Investimeve e Ballkanit Perëndimor, KIBP u prezantua si një mjet rajonal për zgjerimin e BE-së. Qëllimi i tij është që të përforcojë harmonizimin dhe bashkëpunimin e investimeve për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për një zhvillim socio ekonomik të rajonit. Qëllim tjetër është ristrukturimi i faciliteteve ekzistuese të Komisionit Europian dhe të sigurojë burime nga Komisioni Europian, donatorë

shumëpalësh dhe Institucione Ndërkombëtare Financiare partnere.

Përpyqje duhet të çojnë në një koordinim më të mirë me donatorët dhe rritje të kapacitetit për të financuar infrastruktura të rëndësishme në linjë me prioritetet e përcaktuara për aderimin. KIBP synon të maksimalizojë ndikimin e BE-së dhe financimeve bilaterale financimit bilateral duke përdorur kreditimin nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare në bazë të prioritetëve të përcaktuara gjatë procesit të aderimit nga shtetet përfituese

KIBP drejtohet nga Komisioni dhe një Grup i Financuesve të Projekteve⁴.

KIBP është e fokusuar në sektorët kyç të energjisë, mjedisit, transportit, infrastrukturës sociale dhe zhvillimit të sektorit privat. Nga dhjetori 2009 në dhjetor 2010 Komisioni Drejtues i KIBP është mbledhur tre herë dhe ka aprovuar 81 grante për të shtata vendet përfituese. Më poshtë janë disa të dhëna në lidhje me veprimtarinë e KIBP deri më tani:

- Mbi 90% of projekteve të KIBP kanë një mundësi kreditimi me të paktën një nga partnerët e Institucioneve Ndërkombëtare Financiare,
- Aktualisht, ndikimi efektit të lëvrimit shkaktuar nga KIBP është i lartë: për çdo 1 Euro grant të shpenzuar, investimi në total i krijuar ishte 44 Euro.
- Nga 139.2 milion Euro të aprovuara, 116.8 milion janë caktuar nga buxheti i BE-së, 11.1 milion euro nga Fondi i Europian

⁴ Western Balkan Investment Framework, Annual Report 2010

Përbashkët i Ballkanit Perëndimor dhe 11.3 milion nga Institucione Ndërkombëtare Financiare partnere.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme të vërejmë se në procesin e përzgjedhje së projekteve që do të financohen nga KIBP nuk ka pasur pjesmarrje publike. Si Komisioni Drejtues ashtu edhe Grupi i Financimit të projekteve përbëhen nga përfaqësues të KE dhe donatorëve bilateralë. Edhe pse adresa në internet e KIBP bën publike minutat e takimit të organeve drejtuese, është e pamundur për qytetarët ose shoqërinë civile që të përfshihen në procesin e vendimmarrjes. Duke patur parasysh kompleksitetin, rëndësinë dhe potencialin e disa projekteve të infrastrukturës të cilat kanë hyrë në bazën e të dhënave të KIBP, ka një rëndësi të madhe që të mundësohet pjesmarrja e publikut për këte instrument. Komisioni European bën procese konsultimi të vazhdueshme për financimet e tij, KE duhet gjithashtu të sigurojë që të njëjtat praktika të implementohen edhe në rastet e KIBP.

Raste studimore nga shetet e BE-së mbi programimin dhe monitorimin e fondeve të BE-së

1. Hungaria

Pjesmarrja e organizatave të shoqërisë civile hungareze në planifikimin dhe realizimin e programeve operacionale për Fondet Strukturore të Bashkimit Evropian për periudhën 2007-13 (Abstrakt i shkurtuar)

Ky rast është abstrakti i shkurtuar i studimit të përgatitur në fund të vitit 2008 nga by Krisztina Molnár Hegymegi për një kërkim të skuadrës SF për të Ardhmen e Qendrushme, i publikuar me titullin “Fondet Strukturore dhe Partneriteti” (Pragë 2009). Prandaj, gazeta pasqyron situatën e fundvitit 2008 dhe nuk është përditësuar prej atëherë.

Informacioni u grumbullua nga përfaqësuesit e OJF-ve dhe nga zyrtarët të cilët morrën pjesë në procesin e investigimit përmes pyetësorëve dhe 18 intervistave, gjithashtu nga kërkimi në zyrë.

Paragjykim

Në Hungari, aktiviteti i shoqërisë civile mund të konsiderohet shumë intensiv dhe kjo duket edhe nga historia e të shkuarës. Aktiviteti civil është intensifikuar nën influencën e ndryshimit të sistemit politik dhe ekonomik (tranzicion, 1989). Mund të supozohet se mundësia e pjesëmarrjes së shoqërisë në përgatitjen dhe përdorimin e programeve operacionale të Fondeve Strukturore në Hungari

mund të konsiderohet gjithëpërfshirëse në krahasim me përvojat ndërkombëtare. Megjithatë kjo pjesëmarrje nuk është shumë efektive - qeveria përfaqëson vetëm partneritet prej saj.

Ne mendojmë se mendimi i shoqërisë është marrë në konsideratë nga qeveria në një masë të vogël. Anëtarët civile janë përfshirë në një masë të madhe në Komitetet Monitoruese por këta anëtarë kanë pak ndikim në realizimin real dhe aktual të programeve. Duket se nuk ka ndonjë reagim. Vendimet serioze dhe të rëndësishme nuk janë bërë nga Komitetet Monitoruese, fuqia e tyre ka rënë dhe roli i tyre është bërë formal që prej periudhës së 2004-2006. Kjo ngre çështjen se në çfarë mase kjo situatë varet nga vetë anëtarët civile? Ka disa mundësi për OJQ-të për të aplikuar për fondet e BE-së në Hungari, por është mjaft e vështirë për ta për të aksesuar këto burime. Ndryshime të rëndësishme janë të nevojshme në mënyrë që fondet të mund të përdoren me më shumë efektivitet.

Në rrjedhën e punës tonë kërkimore, ne u përpoqëm të gjenim arsyet e këtyre kushteve të supozuara. Në bazë të rezultateve, ne do të bëjmë sugjerime të mëtejshme në mënyrë që të rrisim efektivitetin e proceseve të planifikimit dhe realizimit.

Partneritet në planifikimin e Fondeve Strukturore

Koncepti Kombëtar i Zhvillimit (KKO)

Qëllimi i këtij dokumenti është që të nxjerrë në pah bazat afatgjata (2007-2020) të politikave të zhvillimit në Hungari. Bashkimi Evropian nuk e ka detyruar Hungarinë për të zhvilluar këtë plan - ky ishte një interes vullnetar i qeverisë dhe gjithë shoqërisë!

Edhe pse ka pasur shumë diskutime publike, për më tepër u organizua konferenca e ekspertëve si dhe u mbledhën të dhënat me anë të pyetësorëve në lidhje me temën e Konceptit të Zhvillimit Kombëtar (KZHK), të gjitha këto u kryhen pa një strategji paraprake. Versioni përfundimtar i Konceptit u miratua në dhjetor të vitit 2005 nga Parlamenti hungarez.

Në vitin 2005, një ekip informal pune u ngrit me përfaqësues të FIJT (Fondacioni i Informimit Jofitimprurës dhe Trajnimit), Shoqatës Kombëtare të Ruajtësve (Friends of the Earth Hungari), si dhe Fondacionit Soros me qëllim ndjekjen e debatit publik të Planit Kombëtar të Zhvillimit. Iniciativa ishte i suksesshme dhe shumë shpejt një numër i madh organizatash u bashkua me të.⁵ Roli i grupit të punës i titulluar "OJQ-të për publicitetin e Planit Kombëtar të Zhvillimit (CNNy) kishte marrë një karakter vigjilues.

Ekipi publikoi shtatë raporte rreth proceseve deri në vitin 2008 të cilat janë në dispozicion, së bashku me dokumentet e tjera, në <http://cnny.honlaphat.hu/>. CNNy u pranua nga qeveria si një partner nga ana e shoqërisë civile. Ndër të tjera, CNNy arriti që planifikuesit të përgjigjeshin me shkrim për vërejtjet e dhëna dhe ata dhanë shumë sugjerime praktike në lidhje me procesin e konsultimeve me publikun. Çuditërisht, 40% e propozimeve civile ishin të përfshira në draft pamvarësisht vështirësive të hasura.

Plani i Zhvillimit "Hungaria e Re" (NSRF 2007 - 2013)

Sipas normave ndërkombëtare, Plani i dytë Kombëtar i Zhvillimit (NFT II) u emertua Kuadri Strategjik Kombëtar i Referencës (KSKR). Për një periudhë kohore, partia në pushtet u përpoq ta përdorë dokumentin (nën emrin "Plani i Hungarisë së Re") për fushatën e saj zgjedhore; kjo u kritikua fort midis të tjerëve edhe nga Transparenca Nderkombëtare. Procesi i konsultimit të publikut dy herë rradhazi u koordinua nga Agjencia e Zhvillimit Kombëtar (AZHK), një entitet qeveritar që përfshinte të gjitha autoritetet menaxhuese.

Programet operacionale (PO)

Një faqe përmban të dhënat statistikore të përditësuara mbi përdorimin e Planit të parë për Zhvillim Kombëtar, të dhënat kryesore të të gjitha projekteve të financuara dhe rezultatet e konsultimeve publike të dokumenteve të politikës së zhvillimit janë publikuar në internet. (www.nfu.hu).

Rreth 4000 organizata partnere – midis të cilave ekspertë të ndryshëm dhe grupe lobuese, sindikata,

⁵ <http://cnny.honlaphat.hu/index.php?menu=1408&langcode=hu>.

organizata të shoqërisë civile, si dhe përfaqësues të shkencës dhe të biznesit - u ftuan nga Agjencia me ftesa ose e-mail për të marrë pjesë në procedurën e konsultimit duke përfshirë edhe forume. 1350 organizatat shfrytëzuan mundësinë e dhënë dhe dërguan sugjerimet e tyre në lidhje me PO në formën e një pyetësori të shkarkueshëm ose në formën e një eseje. Shumica e opinionëve u dhanë mbi "PO e ripërtëritjes sociale" dhe "PO e transportit"

Kështu, nga faktet e lartpërmendura arrijmë në përfundim se edhe pse Agjencia Kombëtare e Zhvillimit siguron që të gjithë mund të shkruajnë propozime dhe komente në faqen e tyre, vetëm disa OJQ të përzgjedhura kanë mundësinë për një konsultim të vërtetë, për të këmbyer pikëpamje personale dhe për të marrë pjesë në ëorkshope. Megjithatë, në atë kohë, kriteret e përzgjedhjes të këtyre "partnerëve" nuk kanë qenë të përcaktuara.

Përveç kësaj, KSFR ishte vendosur në rendin e ditës të makro-forumeve të mëdha, të tilla si Këshilli Kombëtar për Pajtimin e Interesave, Komitetit Ekonomik dhe Social, Akademia Hungareze e Shkencave, Këshillit Kombëtar i Mjedisit, Këshilli Kombëtar për Zhvillim Rajonal si dhe Këshilli Kombëtar i Zhvillimit..

Një seri forumesh konsultative u organizuan nga AKZh për të diskutuar të gjitha prioritetet e KSFR; këto prioritete janë si vijon: arsimit, punësimi, shëndeti publik, ekonomia, transporti, reforma shtetërore, zhvillimi rajonal, turizmi, mbrojtja e mjedisit, energjisë – me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të departamentit të veçantë përkatës dhe anëtarit

kompetent të Komisionit Qeveritar për Politikën e Zhvillimit.⁶

Rezultatet

Ne mund të përmbledhim përvojat duke thënë se skuadra që përpunoi propozimet e OJQ-ve pranoi një pjesë të tyre, veçanërisht në rastin e programeve operacionale sektoriale. Rreth 10% e propozimeve u pranuan. Sa i përket PO rajonale, shumica e mendimeve nuk ishin të përfshira në to. Për shoqërinë civile u bë e mundur vetëm të kishin disa pjesë të parëndësishme të përmbajtjes së ndryshuar dhe disa ndryshime në formulim apo gjuhën zbatuar. Autoritetet nuk bënë ndonjë dallim ndërmjet mendimeve të propozuar nga disa palë ëe interesuara por që patën mbështetje të gjerë të publikut , nga ato të disa individëve dhe grupeve të vogla të interesit. Njerëzit që u intervistuan ishin të zhgënjyer kur panë rezultatet. Ata konstatuan se vetëm disa propozime nga shoqëria civile ishin përfshirë në PO dhe u erdhi keq për numrin e madh të orëve të punës të përkushtuara për këtë temë. Sipas tyre kjo është arsyeja pse shoqëria civile është lodhur dhe ka ulur aktivitetin e saj.

Këtu ne duhet të kemi theksojmë se - duke marrë parasysh sfondin historik hungarez dhe atë ekonomiko- social – krijimi i proceseve relativisht të qarta të konsultimit publik, mund të konsiderohet në vetvete një arritje.

⁶ Që nga viti 2007, Agjencia Kombëtare e Zhvillimit në Hungari publikonte shumicën e thirrjeve për propozime për fondet e BE-së për komente publike në internet, në një faqe interneti të vetme (www.nfu.hu), para hapjes së thirrjes. Kjo praktikë është rezultat i avokimit afat-gjatë të OJQ-ve dhe, pavarësisht mangësive të saj, gjithashtu duhet të pranojmë risinë e kësaj praktike dhe karakteristike e saj progresive.

Komisionet Monitoruese (KM)

Në bazë të dekretit të qeverisë hungareze Nr 255/2006 (XII.8), organizatat e shoqërisë civile që përfaqësojnë aspektet horizontale janë të përfshirë në Komisionet Monitoruese; ato janë si vijon: një OJF mjedisore si dhe delegatët e të paktën një organizate të shoqërisë civile që përfaqëson romët, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e çështjeve të barazisë gjinore.

Të gjithë anëtarët e intervistuar të OJQ-ve që janë anëtare të KM kanë të drejtë të votojnë, shumica e tyre janë delegatë të ndonjë platforme civile dhe ishin zgjedhur në mënyrë transparente duke votuar. Shumica e delegatëve ndjejnë një efekt të fortë centralizimi nga ana e qeverisë. Sipas mendimit të delegatëve, KM nuk luajnë një rol të vërtetë në zbatimin apo mbikëqyrjen e PO; KM-ve u jepet vetëm një informacion i shkurtër dhe vendimet e rëndësishme merren tjetërkund. Ndaj, asnjë diskutim i vërtetë nuk ndodh dhe delegatët e shoqërisë civile janë të frustruar nga shumë këndvështrime. BE-ja gjithashtu nuk ka aprovuar që qeveria nuk jep informacion të mjaftueshëm, por sërish nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në këtë drejtim .

Prania e përfaqësuesve të OJQ-ve në komisionet monitoruese është më së shumti e rëndësishme si një burim informacioni (vecanërisht nëse kërkohet informacion shtesë) dhe kontaktesh, pasi ata kanë ndikim relativisht të vogël në realizimin e programeve për shkak të kapaciteteve të ulëta dhe të statusit të pakicës së anëtarëve, edhe pse ata kanë të drejtë vote.

Aksesi i shoqërisë civile në fondet strukturore

Sikundër përshkruhet më sipër, organizatat e shoqërisë civile kanë marrë pjesë në procesin e planifikimit të përdorimit të Fondeve Strukturore në Hungari prej fillimit të tij. Megjithatë, një tjetër qëllim i rëndësishëm i shoqërisë civile është se ajo mund të jetë një partner në shfrytëzimin efektiv të Fondeve Strukturore dhe të ketë akses në këto burime.

Organizatat e shoqërisë civile hungareze mund të paraqesin aplikimet e tyre në fushat e mëposhtme të zhvillimit të përcaktuara në PO: arsimit, shërbimet sociale, mbrojtja e mjedisit, turizmi, punësimi dhe zhvillimi i komunitetit.

Në PO rajonale, organizatat e shoqërisë civile mund të marrin pjesë si aplikantë në konsorciume. P.sh.: ndërtimi pa pengesa, mbrojtja e mjedisit, mundësitë e barabarta.

Përmbledhje

Në mënyrë të përmbledhur, mund të nxjerrim si përfundim se mekanizmat që vepronin para tranzicionit në Hungari, ende ishin në veprim që nga koha kur përdorshin Fondet Strukturore të Bashkimit Evropian. Qeveria paternaliste kishte konsideruar se planifikimi i shpërndarjes së burimeve ishte detyrë e saj.

Shfrytëzimi i burimeve të Fondeve Strukturore u parapri nga një planifikim që ka ndryshuar shumë herë si pasojë e ndryshimeve politike. Sa i përket konsultimit me publikun, nuk është punuar për një strategji të vërtetë për këtë dhe nuk ekzistonte as një kuadër ligjor uniform. Pjesërisht kjo

ishite për shkak të mungesës së përhershme të kohës që përfshirja e shoqërisë civile kishte një karakter ad-hoc dhe ishte shpesh jo transparente. Me rritjen e kontrollit civil, prej vitit 2005, organet qeveritare dhe ato ndërmjetëse janë bërë gjithnjë e më të hapura për konsultim me publikun.

Konsultimi publik në lidhje me programet operacionale është bërë më aktiv në periudhën 2007-2013. Dokumentet e programimit mund të aksesohen lehtësisht nga një publik më i gjerë nëpërmjet internetit. Megjithatë, ministri të ndryshme e marrin në konsideratë mendimin e shoqërisë civile në një masë të ndryshme. Për qeverinë përbën një problem fakti që nuk ka një përfaqësim uniform të shoqërisë civile, dhe që çështjet kryesore horizontale gjithashtu shfaqen me intensitet të ndryshëm. Në nivel kombëtar, grupet mjedisore dhe ata që punojnë për të paaftët dhe të gjymtuarit janë më aktive, ndërsa përfaqësimi i çështjeve gjinore është i vështirë dhe përfaqësimi i interesave të popullatës romë është në një nivel minimal ose jo-ekzistent. Në nivel lokal, vetëm disa mendime të shoqërisë civile mund të përfshihen në Programet Operacionale Rajonale. Lidhur me dokumentat e programimit, mungesa e kohës, mungesa e burimeve për përfshirjen e ekspertëve dhe financimin e kostove të përfaqësuesve të OJQ-ve, janë probleme reale për shoqërinë civile. Në

ditët e sotme duket se shoqëria civile është lodhur. Edhe pse mundësia për të dhënë një kontribut për planifikimin është e hapur për çdo anëtar të shoqërisë, planifikuesit ende ftojnë partnerë të zgjedhur vetëm për ëorkshope reale dhe nuk ka informim të plotë publik në lidhje me këtë.

Shoqëria civile kritikon fuqishëm se përpunimi dhe vlerësimi i komenteve të paraqitura, opinionëve dhe propozimeve nuk është transparent dhe se refuzimi i tyre nuk shpjegohet. Struktura dhe funksionimi i Komisioneve Monitoruese kohët e fundit, nuk është efektive; nuk ka ndonjë reagim të mirëfilltë dhe kontrolli qytetar praktikisht nuk realizohet.

Mbi bazën e punës sonë kërkimore mund të thuhet se një aktivitet civil aktiv mund të jetë ndjerë në Hungari në procesin e planifikimit dhe realizimit të Fondeve Strukturore. Do të ishte e nevojshme të organizoheshin platforma sektoriale për përfaqësinë civile, si dhe për të zhvilluar një sistem uniform delegimi. Përsa i përket qeverisë, transparenca e përpunimit të opinionëve të publikut është thelbësore. Është në interes të të gjithë shoqërisë Hungareze që ekspertë kompetentë të asistojnë të gjithë procesin e përdorimit të fondeve, duke mbështetur kështu dhe duke bërë të mundur më efektiv kontributin dhe pjesëmarrjen demokratike të të gjitha palëve të interesuara.



2. Bullgaria

Eksperienca e OJQ-ve nga programimi i fondeve të BE-së në Bullgari për periudhën 2007-2013

Çfarë është programimi?

“Programimi ka të bëjë me mekanizmat administrative që përdoren për të arritur objektivat e Fondeve Strukturore dhe Kohezionale. Programet shumëvjeçare, të njohura ndryshe si Programe Operacionale, sigurojnë përmbajtjen dhe vazhdimësinë për një periudhë shtatë vjeçare.

Programet kanë lidhje me zona gjeografike specifike të nivelit kombëtar ose rajonal në varësi të qeverisjes vendore në fuqi. Programi synon përfshirjen e prioriteteve strategjike dhe veprimeve indikative, duke nënvizuar alokimet financiare dhe sistemet e menaxhimit dhe të kontrollit. Programi aktual është për periudhën 2007 deri më 2013.”⁷

Edhe pse programimi është për një periudhë të caktuar prej shtatë vitesh, ka shumë hapa në lidhje me procesin e programimit të cilat e kalojnë periudhën prej e shtatë viteve. Këto hapa nuk janë vetëm përgjegjësi e Shteteve Anëtarë apo kandidatë por ndonjëherë edhe të Komisionit Europian. Së pari planifikimi dhe

vlerësimi fillestar⁸ i dokumentave të programimit fillojnë 2-3 vjet para vitit të parë të periudhës. Së dyti kryhen zbatimi dhe monitorimi. Këto vazhdojnë pergjatë të gjithë periudhës shtatë vjeçare (e cila mund të shtyhet edhe më pas duke qënë se financimet vazhdojnë edhe pas vitit të shtatë). Së treti kemi periudhën e pas-vlerësimit⁹ e cila kryhet zakonisht pas përfundimit të periudhës shtatë-vjeçare.

Sipas përcaktimit të principit të partneritetit në artikullin 11 të Regullores së Fondeve Strukturore¹⁰ përgjatë të gjithë hapave një numër i madh aktorësh janë pjesë e procesit të programimit.

“Pjesmarrja e OJQ-ve në komisionet monitoruese, në komisionet për vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve dhe në departamente të tjera përgjegjëse për propozimin, zhvillimin dhe analizimin e projekteve

⁷ http://ec.europa.eu/regional_policy/glossary/programming_en.htm

⁸ Vlerësim i potencialeve të programit, cilësia a tij dhe alokimet financiare <http://wiki.interact-eu.net/display/pc/Practical+Handbook+for+Ongoing+Evaluation+Annex+3>

⁹ <http://wiki.interact-eu.net/display/pc/Practical+Handbook+for+Ongoing+Evaluation+Annex+3>

¹⁰ OJ L 210, 31.07.2006, p. 39
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:210:0025:0078:EN:PDF>

do të çojë në nivele më të larta të transparencës dhe besueshmërisë së institucioneve. Ka shumë pak mundësi për korrupsion kur është prezente shoqëria civile¹¹

Periudha e Parë e Programimit në Bullgari

Periudha prej 2007-2013 ishte periudha e parë e programimit për Fondet Strukturore dhe Kohezionale për Bullgarinë si anëtare e re e BE-së. Zbatimi i principit të marrëveshjes ishte një kërkesë për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve që ishin pjesë e fondeve të para adrerimit "ISPA" dhe "SPARD" (2000-2006). Fondet e paraaderimit duhet të kishin shërbyer për të mësuar qeverinë Bullgare dhe shoqërinë civile se si të planifikonin dhe të përdornin fondet e BE-së.

Duke qënë se procesi i të mësuarit ishte i lodhshëm dhe i gjatë, procesi i planifikimit të fondeve strukturore filluan në 2004. Ky proces nuk ishte shumë transparent dhe njësoj i hapur për të gjithë aktorët e interesuar. Informacioni rreth procesit nuk ishte lehtësisht i aksesueshëm për publikun dhe pothuajse asnjëherë nuk u reklamua.

Porçesi i planifikimit në tërësi përfshinte punën fillestare të grupeve të punës për Planin e Zhvillimit Kombëtar (më vonë të quajtur Korniza Strategjike Kombëtare Referenciale) dhe Programet Operacionale. Roli i grupit të parë ishte analizimi i zhvillimit të vendit dhe përcaktimi i prioriteteve kombëtare në përputhje me nevojat e vendit dhe objektivat e BE-së. Ky

dokument kornizë është strategjia kombëtare për shpenzimet e fondeve të BE-së gjatë periudhës së viteve 2007-2013 të programimit. Grupi tjetër i punës u ngrit me qëllim për të përgatitur Programet Operacionale. Programet Operacionale janë planet konkrete dizenuar për të arritur objektivat kombëtare përcaktuar në Kornizën Strategjike Kombëtare Referenciale. Roli i grupeve të punës së Programeve Operacionale është përcaktimi i objektivave të programit, alokimi i fondeve, menaxhimi dhe mekanizmat e kontrollit.

Planifikimi në grupet e punës duhej të ishte bërë në partneritet dhe duke përfshirë grupet e interesit, siç është e shkruajtur në rregullore. Një mekanizëm i veçantë për angazhimin e OJQ-ve duhej të ishte zhvilluar nga Ministria e Financës.

E megjithatë, pasi u përcaktuan grupet e punës, përbërë kryesisht nga zyrtarë dhe partnerë socialë-ekonomikë (sindikata pune, shoqata tregëtie) OJQ-të pothuajse nuk ishin pjesëmarrës.

Disa OJQ Bullgare, si psh. Za Zemiata dhe CEIE, që të dyja anëtare të CEE Bankwatch Network, kishin eksperiencë me monitorimin e fondeve të paraaderimit duke qënë edhe anëtarë të Komisioneve të Monitorimit. Këto organizata ishin të parat të cilat kërkuan autoriteteve pjesëmarrjen e OJQ-ve mjedisore.

Ka disa arsye që OJQ-të nuk ishin prezentë në grupet e punës që nga fillimi. Më të rëndësishmet prej tyre janë:

1. -të nuk mendoheshin si partnerë të rëndësishëm për autoritetet
2. Mekanizmi që përzgjidhte OJQ-të nuk ishte zhvilluar dhe nuk i ishte shpërndarë autoriteteve
3. Rregulloret kombëtare të cilat përcaktonin parimin e

¹¹Statement of the NGO Coalition "For sustainable use of European funds 2007-2013" Ne lidhje me zbatimin e principeve të partneritetit gjatë procesit të draftimit të struktureve bullgare për përdorimin e fondeve të EU-se (2007-2013) p. 1, http://bankwatch.org/documents/comments_partner_ship_2007_March_en.pdf

partneritetit u dobësuan ndjeshëm gjatë periudhës 2004-2007

4. Vetëm disa OJQ ishin në dijeni të procesit të programimit dhe kishin përcaktuar kapacitete për të marrë pjesë.

Në përgjithësi në fillim të programimit në vitin 2004 OJQ-të nuk ishin prezente ose përcaktoheshin nga administrata dhe në pak raste OJQ-të organizonin zgjedhje mes tyre për të përcaktuar përfaqësuesit e tyre¹².

Cfarë bënë OJQ-të gjatë programimit?

Za Zemiata dhe CEIE, ndërkohë që dërgonin letra dhe takonin zyrtarë duke kërkuar përfshirje inicuan themelimin e Koalicionit për një përdorim të qëndrueshëm të fondeve të BE-së¹³. Ideja ishte ngritja e kapaciteteve brenda OJQ-ve mjedisore dhe pjesmarrja në planifikimin e fondeve të BE-së. Në ditët e sotme koalicioni është më i gjerë dhe monitoron e vlerëson zbatimin në nivel kombëtar dhe rajonal.

Në 2009 dhe 2010 koalicioni prodhoi disa dokumenta në lidhje me monitorimin e fondeve të BE-së. Disa prej dokumentave janë: “Një guidë për shoqërinë civile në monitorimin e fondeve të BE-së”; “Raportim i Monitorimit mbi Fondet Strukturore në Bullgari, Qershor 2010¹⁴; 101 organizata folën rreth fondeve të BE-së

¹²OJQ-të mjedisore përdorin platformën elektronike “Civic e-governance” për të përzgjedhur përfaqësuesit e tyre

http://vote.bluelink.net/ngovote_info.php, the platform njihet gjithashtu edhe nga shumë institucione. Kjo platformë do të zgjerohet për të përfshirë edhe OJQ të fushave të tjera..

¹³Adresa e internetit e koalicionit: <http://www.bluelink.info/eu-funds/> though statements are not available

në Bullgaria¹⁵; Koalicioni tani po përfshihet në përgatitjet për periudhën tjetër të programimit (2014-2020)¹⁶ dhe bashkëpunon me koalicione të tjera për të siguruar pjesmarrjen e OJQ-ve në programimin e dokumentave strategjikë për periudhën 2014-2020. Deri më tani kjo përfshinte përgatitjen e disa letra të përbashkëta, deklaratave dhe një studimi¹⁷. Si rezultat disa ministri u ofruan këtyre koalicioneve të bashkëpunonin me grupet e punës për përgatitjen e programimit.

Përgjatë planifikimit të Planeve Operacionale, Koalicioni negocoi për të marrë pjesë në grupet e punës. Ai gjithashtu komentoj mbi dokumenta të ndryshëm në lidhje me transportin, mjedisin, principe të partneritetit, VSM-të dhe Planeve Operacionale. Fatkeqësisht shumica e komenteve nuk u morrën parasysh pa asnjë lloj justifikimi.

Një sukses ishte fakti që përfaqësimi i OJQ-ve në Planet Operacionale për Mjedisin ishte mjaft aktiv. Gjithashtu u menaxhua që të bindeshin kolegët që fondet e BE-së për burimet e rinovueshme të përjashtoheshin nga fondet e menaxhuara nga ministria e Energjitikës nën Planet Operacionale për mjedisin. Kjo vërtetoi që thjesht të qënurit pjesë e një grupi pune nuk

¹⁴Raporti i plotë në Bullgarisht <http://fesbg.org/node/162> All rights reserved©2010, PECSD, Varna ISBN 978-954-2904-01-4 (English summary upon request from the Coalition's secretariat)

¹⁵101 организации говорят за европейските фондове в България. All rights reserved©2010, PECSD, Varna. ISBN 978-954-90952-9-6, <http://fesbg.org/node/186> (in Bulgarian)

¹⁶Adresa e re e internetit e koalicionit <http://www.fesbg.org/>

¹⁷Sfidat e programimit të ri të Fondeve të BE-së në Bullgari pas vitit 2013, bazuar në analizën e eksperiencës së viteve 2007 – 2013 (Përmbledhje në Anglisht)

http://www.osi.bg/downloads/File/EU_Funds_summ ary_eng.pdf

mjafton, por pjesmarrja aktive dhe e informuar është shumë e rëndësishme.

OJQ-të Bullgare i dorëzuan komentet e tyre Komisionit Europian. Qëllimi ishte që ndërkohë që vlerësoheshin dokumentat strategjikë, Komisioni Europian të ushtronte presion mbi qeverinë Bullgare për komentet e OJQ-ve. Ndikimi i këtyre aksioneve është i vështirë për tu vlerësuar, e megjithatë OJQ rritën ndërgjegjësimin e Komisionit Europian për çështje specifike në Bullgari dhe krijuan besueshmëri si një burim i rëndësishëm informacioni mbi fondet e BE-së. OJQ-të mjedisore në Bullgari kanë një histori të gjatë komunikimi me “Komisioni Europian ka një eksperiencë të pasur me komisionet monitoruese (ISPA, SAPARD) dhe me institucionet Bullgare.

OJQ-të shpesh paraqesin të dhëna dhe qëndrime kontradiktore me të dhënat zyrtare; shpesh ato sillnin zgjidhje alternative dhe ndikonin në një analizë më efikente të problemit. Opinioni i publikut merrej gjithmonë parasysh, por për fat të keq Ministria e Financave përjashtoi OJQ-të mjedisore nga Komisionet Monitoruese ISPA për shkak të pozicionimit të tyre mjaft kritik përkundrejt punës së institucioneve Bullgare dhe cilësisë së disa projekteve të infrastrukturës (Autostrada Lyulin 3, Aeroporti i Sofies, etj.).¹⁸

Megjithatë, në programimin për periudhën 2007-2013, zyrtarët nuk u treguan dhe aq të ashpër. Me qëllim që plani të bëhej më transparent dhe i prekshëm nga të gjithë, qeveria

¹⁸Deklaratë e koalicionit të OJQ-ve “Për një përdorim të qëndrueshëm të Fondeve Europiane 2007-2013” në lidhje me: Zbatimin e principit të partneritetit në procesin e draftimit të dokumentit të kornizës ligjore Bullgare për përdorimin e fondeve të BE-së (2007-2013) fq. 1, http://bankwatch.org/documents/comments_partner_ship_2007_March_en.pdf

organizoi disa forume me diskutime të hapura, ku të gjitha Planet Operacionale ishin të përfaqësuara nga anëtarët e grupeve të punës respektive. Të gjitha idetë dhe komentet e mbledhura gjatë forumeve u shkëmbyen në publik nga grupet e punës. Për më tepër, çdokush mund të merrte pjesë në këto diskutime, duke qënë se forumet ishin të hapura për publikun e gjërë. OJQ-të ishin shumë aktive në këto forume dhe ishin pothuajse të vetmet që përfaqësonin shoqërinë civile dhe flisnin në emër të saj. Personalitete të rëndësishme ishin gjithashtu të pranishëm në këto forume, mes tyre ministra, ambasadorë dhe përfaqësues të Këshillit Europian. Nëqoftëse kjo është ajo çka edhe vendi yt po bën, atëherë përgatitja dhe pjesëmarrja e OJQ-ve në këto forume, do të ishte me rëndësi

Disa përfundime mbi procesin e programimit u paraqitën në 2007 nga OJQ-të, ku mes të tjerash thuhet: “Përfundimi ynë është që shumë prej proceseve ndryshojnë si pasojë e lobimit të ministrave, organizatave apo edhe të njerëzve sesa si pasojë e diskutimeve të grupeve të punës. Kjo është arsyeja për të cilën ne besojmë se procesi i programimit në gjithë tërësinë e tij është i bazuar mbi vendime politike dhe grupet e punës janë vetëm për të bërë zyrtare këto vendime dhe për ta bërë procesin të duket “demokratik”. Si rrjedhojë, problemi kryesor nuk është pjesëmarrja e OJQ-ve, por pamundësia e hartimit të programeve të bazuara mbi diskutimet e nxjerra nga grupet e punës, programe të cilat janë në përputhje me rregulloren e planifikimit të BE-së.”¹⁹

¹⁹Deklaratë e koalicionit të OJQ-ve “Për një përdorim të qëndrueshëm të Fondeve Europiane 2007-2013” në lidhje me: Zbatimin e principit të partneritetit në procesin e draftimit të dokumentit të kornizës ligjore Bullgare për përdorimin e fondeve të

Disa mësimë të nxjerra dhe rekomandime:

- OJQ-të duhet të jenë më të përfshirë në hartimin e dokumenteve të programimit në nivel kombëtar dhe rajonal.
- OJQ-të duhet të kërkojnë partneritet strategjik dhe duhet të organizohen në koalicione;
- OJQ-të duhet të furnizojnë si autoritetet kombëtare si Këshillin European me informacion të detajuar dhe të saktë;
- OJQ-të duhet të caktojnë burime (financiare dhe njerëzore) me qëllim pjesëmarrjen në programim;
- OJQ-të duhet të insistojnë të kenë të drejtën e plotë të votës
- OJQ-të duhet të jenë të përgatitura për një rrjedhë jo të rregullt të informacionit si dhe për kohën e shkurtër rezervuar konsultimeve. Për t'i evituar këto, është e këshillueshme që OJQ-të të kenë përgatitur kërkesat e tyre që më parë

3. Sllovakia

Vlerësimi i procesit të programimit të fondeve të BE-së për periudhën 2007-2013 nën këndvështrimin e pjesëmarrjes së OJQ-ve

Pas problemeve jo te vogla që u hasën gjatë programimit të fondeve për periudhën e shkurtër kohore 2004-2006, OJQ-të në Sllovaki kishin për synim kryesor mos përsëritjen e këtyre mangësive në procesin e ardhshëm të programimit.

Si pasojë, që në hapat e para të programimit për periudhën 2007-2013 (Dhjetor, 2004), anëtarët e OJQ-ve të përfaqësuar në Ekipin e Pavarur "the Independent Civic Watchdog Team"²⁰ ranë dakort mbi disa parime bazë të procesit, të cilat duhet të respektoheshin me qëllim që të evitoheshin një proces kaotik dhe jo transparent si ai i viteve 2004-2006. Këto parime së bashku me një sërë rekomandimesh në lidhje me procesin iu dorëzuan ekipit programues të

qeverisë por pothuajse nuk u morrën në konsideratë..

Për shembull, OJQ-të nuk ishin informuar se si komentet e tyre ishin trajtuar nga autorët e analizës për Kornizën Strategjike Kombëtare Referenciale (KSKR), as propozimi final i analizës nuk ishte publikuar (ky propozim nuk kishte mbaruar as gjatë përgatitjeve të draftit të parë të KSKR, i cili ishte dorëzuar për komente). Për më tepër, objektivat strategjike dhe prioritetet e KSKR ishin të caktuara nga qeveria përpara se të përpilohej analiza, e cila do të shërbente si baza e programimit. Si rrjedhojë, i gjithë dokumentacioni u kthye në prioritete dhe qëllime strategjike të paracaktuara. Harku kohor i vënë në dispozicion për shqyrtimin e materialeve të rëndësishme u reduktua në pesë ditë, ndërkohë që në raste të tjera harku kohor ka qenë prej dhjetë ditësh. Ky reduktim në kohë është justifikuar gjithëmonë me arsyen absurde "pesë ditë për shkak të çështjeve të BE-së".

Pavarësisht nga insistimet e qeverisë për një proces programimi sa më transparent dhe një pjesëmarrje të gjerë, procesi në të vërtetë dështoi që në hapat e tij të parë dhe nuk u dallua për pjesëmarrje të gjerë. OJQ-të paralajmëruan vazhdimisht qeverinë se kjo nuk duhet të ndodhte dhe u përpoqën të ndalonin lojërat e

²⁰ Ekipi mbikqyrës është iniciuar në vitin 2001 nga miqtë e Tokës -CEPA si një reagim ndaj menaxhimit jo-transparente të fondeve të BE-së; një nivel i ulët i integritetit të bashkive, qeverive rajonale dhe OJQ-të në programim dhe implementim, si dhe deficit kritik mbi informacionin e aksesueshëm nga publiku. Aktualisht Miqtë e Tokës-CEPA koordinon ekipin vigjilent dhe anëtarët e saj janë përfaqësues të OJQ-ve që punojnë në komisione zyrtare monitoruese dhe grupeve të punës të përfshira në programimin dhe monitorimin e fondeve të BE-së. Gjithashtu ekipi i mbikqyrës përfshin ekspertë të pavarur në politikën e zhvillimit rajonal, në financat publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Pjesëmarrja në ekipin mbikqyrës është vullnetare.

'parteritetit dhe programimit' të periudhës së kaluar. Për fat të keq, nuk patën pothuajse asnjë ndikim.

Si pasojë, drafti i parë i lëshuar për komente nga KSKR në shtator të vitit 2005 ishte më fakt një dokument i papranueshëm, i njëanshëm dhe jo koherent i bazuar më tepër në rritjen ekonomike sesa në zhvillimin e qëndrueshëm. Disa ditë mbas skadimit të afatit për dorëzimin e komenteve mbi draftin, qeveria organizoi dy konferenca rajonale për të pranishmit e ftuar ku do të diskutohej rreth draftit. Pa lajmëruar, një version i modifikuar i KSKR -së u paraqit në këto konferenca. Ky version i NSRF-së nuk u publikua dhe përmbante disa ndryshime të bëra në mënyrë artificiale me qëllimin e vetëm për të plotësuar kërkesat e OJQ-ve, të cilat bënin thirrje për zhvillim të qëndrueshëm. Ky version i draftit u miratua nga qeveria në mes të Tetorit, 2005. E gjitha kjo rikonfirmoi edhe një herë tendencën për të ndjekur te gjithë procesin sa për sy e faqe, një proces që më fakt bazohej tashmë nga objektiva dhe prioritetet e pararendosura. OJQ-të nuk e pranuan diçka të tillë dhe lajmëruan se do të bojkotonin programimin e mëtejshëm të procesit, si dhe monitorimin e Fondeve Strukturale dhe Kohezionale të BE-së në Sllovakia (Dhjetor 2005), derisa të përpunohej një draft i dytë i cili do të karakterizohej nga një diskutim i lirë dhe i paanshëm dhe nga inputi i partnerëve socialë. Media dhe Këshilli Evropian u informuan mbi këtë hap dhe u mbajtën të informuar rreth zhvillimeve të mëtejshme.

Pas njoftimit për bojkot, autoritetet shprehën gadishmërinë e tyre për bashkëpunim me OJQ-të dhe paraqitën disa propozime të cilat lejuan pjesëmarrjen e disa prej kërkesave të OJQ-ve në versionin e ri të KSKR-së. Zyrtarë të qeverisë organizuan një

mledhje me përfaqësuesit e OJQ-ve në Janar, 2006 në të cilën parashtruan pozitën e tyre në lidhje me propozimet e OJQ-ve si dhe qëllimin e tyre për të përfshirë OJQ-të në programimin e mëtejshëm. Gjatë mbledhjes, disa nga komentet e OJQ-ve u pranuan, gjithësesi asnjë nga vërejtjet lidhur me uljen e pabarazisë rajonale nuk u morr në konsideratë. Pas mbledhjes, ishte e qartë se autoritetet qeveritare nuk do të ndryshonin qëndrimin, as synimin e tyre kryesor të KSKR -së mbi zhvillimin ekonomik. Megjithatë, një hap përpara u bë përse i përket OJQ-ve, komentet e të cilave ishin të predispozuara të trajtoheshin në nivele programesh individuale, ndërkohë që, nga Shkurti 2006, OJQ-të do të riktheheshin në procesin e programimit dhe do të ndikonin në përgatitjen e programeve më të rëndësishme operative.

Drafti i dytë i KSKR u paraqit për komente nga mesi i muajit Shkurt 2006 (afati për shqyrtim ishte dhjetë ditë pune, pas kësaj do të fillonte përgatitja për Programet Operative). Ky version përfshinte disa nga kërkesat e OJQ-ve. Duke marrë në konsideratë progresin e bërë, OJQ-të vendosën të mbyllin përkohësisht bojkotin, duke paraqitur komentet e tyre rreth dokumentit.

Mbas mbylljes së komenteve mbi draftin e KSKR-së në Mars 2006, qeveria e shtyu aprovimin për disa javë, duke mos ftuar kështu palët e ndryshme për të marrë pjesë në proces si dhe ndryshoi propozimin në gjërat thelbësore që ai trajtonte, ndryshime veçanërisht të lidhura me strukturën e Programeve Operative si dhe me ndarjen e fondeve. Pasi drafti i ndryshuar u miratua nga qeveria në Maj 2006, u bë mëse e qartë se qeveria e drejtuar në ato kohë nga z. Dzurinda kishte për qëllim të vetëm të shpejtonte procesin e hartimit të

programit para zgjedhjeve parlamentare, të cilat do të mbaheshin në Qershor 2006. Përgatitjet për programet operative individuale u karakterizuan nga e njëjta gjëndje kaotike. Këto përgatitje shfaqën të njëjtat mangësi ashtu si dhe përgatitja për draftin e KSKR: afatet kohore të vëna në dispozicion për komente u shkurtuan përsëri, materialet për diskutim dergoheshin vetëm disa ditë përpara mbledhjes. Kjo gjë bëri të pamundur jo vetëm pjesëmarrjen aktive të OJQ-ve por edhe të palëve të tjera të përfshira në proces si psh. qeveritë rajonale dhe vendore apo përfaqësuesit e tjerë të palëve përfituese. Harku kohor i vënë në dispozicion për komente u limitua sërish në pesë ditë dhe e njëjta arsye absurde u përdor për justifikim “për shkak të problemeve të BE-së”. E gjitha kjo bëri që asnjë nga komentet e OJQ-ve të mos ishte përfshirë në draftin e Programeve Operative.

Në korrik 2006, me krijimin e qeverisë së re, OJQ-të dërguan një letër kryeministrit dhe ministrave, në të cilën vinin në dukje të metat e procesit të programimit dhe kërkonin një zgjidhje të situatës. Pas kësaj u vunë re përpjekje nga organet shtetërore për ndryshime në përmbajtjen e dokumentave të KSKR dhe Programeve Operative, ndryshime të cilat mund të jenë në të njëjtën linjë me kërkesat e OJQ-ve. Megjithatë, procesi i ndryshimit për sa i përket drafteve të dokumentave, ka qenë një proces problematik, më së shumti për shkak të procedurave të paqarta dhe limiteve kohore.

Përmbledhje

Proçesi i programimit të fondeve të BE-së nën këndvështrimin e

pjesëmarrjes së OJQ-ve për periudhën 2007-2013 ishte i ndryshëm nga ai i viteve 2004-2006. Megjithatë, pavarësisht disa përmirësime, roli i OJQ-ve ishte minimal, duke qenë se nuk kishin ndikim real për të ndryshuar përfundimet e programimit. Si pasojë e mangësive të shumta, procesi u bojkotua nga OJQ-të rreth fundit të 2005 dhe fillimit të 2006. Përfundimi i komplet procesit në mënyrë të sukseshme u bë më tej i pamundur duke marrë parasysh fillimet e tij të dobëta dhe me probleme.

Në përgjithësi, mund të thuhet se pavarësisht nga disa përpjekje nga ana e autoriteteve të shtetit dhe përmirësimeve të vogla sidomos mbas zgjedhjeve në qershor 2006, dhe ardhjes në pushtet të qeverisë së re, deri në fund të procesit të programimit (dhjetor 2006), autoritetet nuk arritën as të ndryshonin qëndrimin e tyre ndaj OJQ-ve, as të bënin ndryshime në dokumentacion, çka do të lejonte Fondet Strukturore dhe Kohezionale të ndikonin në eliminimin e disbalancave rajonale në shtatë vitet e ardhshme.

Rekomandime

Ky rast tregon se palët që marrin pjesë në procesin e programimit duhet të dinë sesi të mbrojnë interesat e tyre. Në të ardhmen, në mënyrë që procese të tilla kaotike të mos përsëriten, është e nevojshme që rregullat e funksionimit të programimit të jenë të caktuara që më parë. Gjithashtu, ato nuk duhen të jenë të ndikuara nga vendime politike të momentit:

1. Proçesi i programimit për NSRF dhe programet operative duhet të hartohen që më parë dhe të gjitha palët që marrin pjesë në programim duhet të bien dakort që më parë. Çdo ndryshim në afatet kohore apo çdo ndryshim tjetër që mund të dalë gjatë proçesit duhet të diskutohet që më parë nga palët.

2. E gjithë struktura për proçesin duhet të jetë e mirëpërcaktuar në legjislacion, në mënyrë të tillë që rregullat e proçesit të jenë të detyrueshme me ligj.

3. Gjatë proçesit duhet të ketë kohë të mjaftueshme të vënë në dispozicion për komente që i bëhen drafteve (të paktën dy javë ose më shumë në varësi të madhësisë së dokumentit) në mënyrë të tillë që palët të kenë kohë të mjaftueshme për rishqyrtim.

4. Dokumentat për mbledhjet e grupeve të punës duhen të dorëzohen dhjetë ditë përpara mbledhjes në mënyrë të tillë që palët të kenë kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur.

Pëmbledhje e pjesëmarrjes së publikut në vendet e Ballkanit perëndimor në IPA

Shqipëria

General legislative framework

Përprojekjet e para për të mundësuar informimin dhe pjesëmarrjen e publikut mbi çështjet mjedisore në Shqipëri ka filluar në vitin 2000 kur Konventa e Aarhus-it u miratua nga Parlamenti shqiptar nën ligjin “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” (Ligji Nr.8672, datë 26.10.2000). Në vazhdim të konventës së Aarhusit disa ligje të tjera janë miratuar për të siguruar përfshirjen e publikut në vendimmarrje. Këto janë Ligji nr.10440, datë.07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”; Ligji nr.10431, datë: 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.994, datë 2.7.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”; Ligji nr.91/2013 datë 19.03.2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”

Aktualisht, duke qenë se vendi është duke synuar të bëhet pjesë e BE-së, Ministria e Mjedisit është duke punuar për të përshtatur kërkesat e acquis mjedisor në legjislacionin kombëtar. Pavarësisht kësaj dëshire të mirë, përprojekjet nuk kanë qenë të sukseshme. Ministria ka një informacion të pa plotë për gjëndjen e

mjedisit në vend për shkak të një monitorimi jo eficient. Ligjet e reja të miratuara duke qenë se janë thjesht një përkthim i direktivave përkatëse të BE-së, janë larg nevojës dhe realitetit shqiptar

Pavarësisht nga kuadri ekzistues ligjor, kapaciteti administrativ për të zbatuar ligjet mbetet i dobët si në nivel kombëtar dhe në nivel lokal. Për më tepër që mungon dhe një koordinim ndërmjet Ministrisë së Mjedisit me ministrinë e tjera dhe me organe të tjera qeveritare në nivel lokal dhe kombëtar. Për momentin një vëmendje e madhe i kushtohet përmirësimit të zbatueshmërisë së acquis mjedisor dhe në përforcimin e legjislacionit kombëtar

Praktikat për pjesëmarrje dhe e së drejtës së informacionit së publikut në nivel projekti

Pas miratimit të Konventës së Aarhus-it në vitin 2000, janë përdorur mekanizma të ndryshëm në mënyrë që vendi të mund të zbatonte në mënyrën e duhur konventën. Si rrjedhim, me mbështetjen e pranisë së OSBE-së në Shqipëri, u hapën tre qendra Aarhus-i në tre qytete të Shqipërisë: Shkodra, Vlora dhe Tirana

Një bord i konventës së Aarhus-it u krijua në vitin 2009, më përfaqësi nga ministri dhe OJF të

ndryshme. Megjithatë bordi i Aarhus-it në Shqipëri është një strukturë nën Ministrinë e Mjedisit dhe për këtë arsye i mungon pavarësia. Bordi ka vetëm një mandat këshillues që në përgjithësi është mjaft i dobët në krahasim me vendimet qeveritare.

Ende në nivelin e projekti, çfarëdo zbatimi të ketë Konventa e Aarhus-it kryhet në një mënyrë shumë minimale. Për fat të keq kjo ndodh edhe kur projektet janë të financuara nga Institucione Europiane. Në 2004 Banka Europiane për Zhvillim dhe Rindërtim, Banka Europiane e Investimit dhe Banka Botërore financuan ndërtimin e termocentralit me cikël të kombinuar të naftës dhe gazit në qytetin e Vlorës, në jug të Shqipërisë. Projekti kishte mangësi në realizimin e konsultës së duhur me publikun, fakt i cili u konfirmua në vitin 2007 edhe nga Komiteti i Ankimimit të Konventës së Aarhus-it.

Raporti i Komitetit të Ankimimit të Konventës së Aarhusit nuk duket se pati ndikim të madh në të ardhmen e procesit të konsultimit me publikun në Shqipëri. Këtë fenomen do ta vëmë re në vitin 2013 ku në shumicën e rasteve mendimi i publikut është tërësisht i përjashtuar ose i injoruar. Raste si Unaza e madhe e Tiranës janë një rast aktual për sa më sipër, ku ndërtimet nisëm pa leje ndërtimi, pa leje mjedisore dhe pa realizimin e një dëgjese të vetme me publikun.

Përfshirja e OJF-ve në konsultime partneriteti

Në 24 shtator 2010 Ministria shqiptare e Integritit European realizoi një takim konsultues mbi Kuadrin Strategjik të Koherencës (KSK) për komponentët IPA III dhe IV. Ftesa i drejtohej aktorëve të ndryshëm si

përfaqësuesëve të pushtetit lokal dhe qëndror, prezencave diplomatike në vend, organizatave ndërkombëtare duke përfshirë dhe një numër të vogël të OJF-ve lokale.

Edhe pse data e konsultimit ishte njoftuar dy muaj më parë, në korrik të 2010, dokumenti i propozuar për Kuadrin Strategjik të Koherencës u bë publik vetëm në datën 21 shtator, tre ditë para realizimit të konsultës,. Natyrisht kjo kohë e shkurtër nuk ishte e mjaftueshme për OJF-të për të studiuar dokumentin në mënyrën e duhur dhe për të patur komente të vlefshme. Për më tepër përkthimi në shqip i dokumentit nuk ishte i saktë, duke reflektuar në këtë mënyrë mungesën e seriozitetit të procesit. Në vazhdim të konsultimit OJF-ve iu vu në dispozicion vetëm një javë kohë për të dërguar komente shtesë

Për më tepër, mënyra e organizimit të konsultës i lejonte OJF-të që të merrnin pjesë vetëm në një nga pesë sesionet që organizoheshin njëkohësisht: transporti, mjedisi, konkurrenca rajonale, tregu i punës dhe arsimimi dhe formimi profesional . Për OJF-të ishte mjaft e vështirë për të ndikuar në përzgjedhjen e prioriteteve në sektorin e transportit për shembull Grupi i punës për transportin vuri si prioritet të këtij sektori zhvillimin e autostradave duke mos përfshirë edhe një herë tjetër transportin hekurudhor si prioritet zhvillimi të këtij sektori. Që prej vitit 2010 nuk janë zhvilluar konsulta të tjera. Konsultimet dhe proceset e pjesëmarrjes publike në lidhje me programimin e fondeve IPA dhe zbatimin e projekteve të përzgjedhura janë disi të paqartë dhe nuk ndjekin një përfaqëse pjesëmarrjeje dhe transparence Qendra mejdisore EDEN në bashkëpunim me Delegacionin e Bashkimit European të Shqipërisë dhe Ministrinë e Integritit

European ka realizuar dy tryeza të rrumbullakta dhe disa takime duke advokuar për përfshirjen e OJF-ve në procesin e programimit të fondeve IPA. Gjithashtu letra zyrtare i janë dërguar Ministrisë së Integritimit European duke kërkuar pjesëmarrje dhe përfshirje aktive të OJF-ve në proces dhe në komitetet e monitorimit

Niveli njohës i organizatave të

shoqërisë civile, mbi ciklin e programimit dhe të fondeve IPA në përgjithësi është i ulët. Ky është një proces i ri mësimi ku një pjesëmarrje më e mirë është e nevojshme në mënyrë që të rritet transparenca. Proçesi në pamjen e tërë të tij nuk krijon hapësira për një pjesëmarrje të vërtetë dhe kontribut të vazhdueshëm nga sektori i OJF-ve.

Korniza Ligjore e përgjithshme

Në Kroaci, të drejtat e publikut për përfshirje në vendim-marrje janë të përshkruara në disa ligje dhe dekrete të veçanta. Më i rëndësishmi prej tyre është dekreti për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazetë zyrtare 110/2007), dhe Rregullorja mbi Informim dhe Pjesëmarrje të Publikut mbi çështjet mjedisore (Gazetë zyrtare 064/2008). Ekziston gjithashtu edhe Ligji mbi të drejtën e informimit (Gazetë zyrtare 172/2003).

Dekreti për mbrojtjen e mjedisit dhe rregulloret e tij përcaktojnë mënyrën sesi publiku duhet informuar lidhur me procedurat e: zhvillimit të studimeve VNSM, vlerësimin e nevojave për Vlerësim Strategjik Mjedisor; vlerësim të nevojave për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis; duke përcaktuar përmbajtjen e Studimeve të ndikimit në mjedis para zhvillimit të tij dhe procedurave të marrjes së miratimit në Raportin e Sigurisë.

Dekreti përcakton gjithashtu mënyrën e informimit të publikut si dhe përfshirjen e tij në procedurat e mëposhtme: Vlerësim Strategjik Mjedisor, adoptim planesh dhe programesh për të cilat nuk është kryer një vlerësim strategjik mjedisor, përgatitje e ligjeve, implementimi i ligjeve dhe rregullave të tjera të ngjashme që kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi mjedisin, vlerësim i ndikimit në mjedis, dhe përcaktimi i kërkesave për mbrojtjen e mjedisit për fillimin e aktiviteteve të reja. Veç kësaj, dekreti përcakton edhe mënyrën sesi duhet të organizohen

debatet publike, duke përfshirë këtu inspektimin dhe ekspozimin e gjerë të publikut, si dhe afateve kohore përkatëse.

Të dyja këto akte legislative plotësojnë kushtet e marrëveshjes së Aarhus-it, e cila u pranua dhe u miratua nga parlamenti kroat në 13 dhjetor 2006 (Gazeta zyrtare, kontrata ndërkombëtare; 01/07). Edhe pse Republika e Kroacisë e miratoi marrëveshjen në 2009, Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Ndërtimit hodhi në gjyq Zelena Akcija-n për shkak të protestave mbi administrimin e mbeturinave toksike. Ne jemi të mendimit që Kroacia ka shkelur kushtin e marrëveshjes së Aarhus-it i cili thotë se: “personat që përdorin të drejtën e tyre bazuar mbi marrëveshjen e Aarhus-it nuk duhen dënuar, ndjekur penalisht, apo shqetësuar”. Në të kundërtën, ngritja e gjyqeve kundër OJQ-ve me kërcënime për gjoba të larta financiare, nuk tregon partneritet dhe bashkëpunim të mirë midis Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit dhe Ndërtimit dhe sektorit civil. Në 2011 Zelena Akcija arriti më në fund të fitojë gjyqin.

Pjesëmarrja e publikut dhe aksesit i informacionit në nivel projekti

Pjesëmarrja e publikut në procedurat e VNM-së në Kroaci nuk është efikase, pasi qytetarëve nuk ju lejohej të ndryshojnë në mënyrë drastike as projektet, as vendndodhjen e tyre. I vetmi rast, në të cilin problemi i vendit mund të diskutohet është gjatë planifikimit hapësinor – fazë në të cilën ndikimi mjedisor i projekteve njihet në

detaje. Për shembull versioni final i qendrës së menaxhimit të mbetjeve në Mariscina; VNM-ja përfundoi në vitin 2001 dhe bazohet në faktin që vlerësimi i vendndodhjes në Mariščina është caktuar si më e përshtatshme për vendin si qendër e menaxhimit të mbetjeve. Ky informacion flet vetë. Vlerësimi i pothuajse dhjetë viteve i ndikimit dhe pasojave mbi mjedisin, nuk mund të justifikojë përfshirjen e fondeve të BE-së në këtë projekt. E njëjta gjë ndodhi edhe me projektin e dytë të financuar nga BE-ja – bëhet fjalë për qendrën e menaxhimit të mbeturinave Kastijun, vendndodhja e së cilës ishte zgjedhur në 2006 dhe kur VNM u prezantua në 2007, qytetarët nuk u lejuan të kishin asnjë lloj ndikimi mbi vendndodhjen e saj.

OJQ-të e përfshira në konsultime partneriteti

Qeveria kroate miratoi Kornizën e zhvillimit Strategjik 2006-2013 në shtator 2006. Kjo kornizë u miratua zyrtarisht pas dy raundesh konsultimesh publike me sindikatat, organizatat jo qeveritare, shoqatat e biznesit dhe publikun e gjerë. Megjithatë nuk ka asnjë provë, është e vështirë të kuptosh se cilat organizata kanë qenë me të vërtetë pjesëmarrëse në konsultimet e bëra.

Një nga problemet më madhore që Kroacia po has në përpjekje për tu bërë pjesë e BE-së është harmonizimi me legjislacionin e BE-së, çka rezultoi në kalimin e disa ligjeve "Europiane" në parlamentin Kroat. Disa prej OJQ-ve, si psh "Zelena Akcija"/"Friends of the Earth" kanë dhënë disa konferenca për shtyp, në të cilat kërkohet që qeveria dhe parlamenti Kroat të zvogëlojnë numrin e ligjeve që kalojnë në parlament pa u dhënë rëndësia e

duhur, pa u lexuar në parlament dhe si rrjedhojë pa ndonjë debat në publik. Sipas rregullave të procedurave të parlamentit Kroat, kalimi i ligjeve me procedurë urgjente, ishte i parashikuar vetëm në raste të jashtëzakonshme si psh. për mbrojtje dhe siguri kombëtare apo për arsye të tjera të justifikuara nga shteti Kroat. Gjatë mandatit të qeverisë së mëparshme, nuk kishte lajmërim për sa i përket mbledhjeve të qeverisë. Gjithashtu, njoftime për ndryshime apo adoptime të disa nga pikave të programit, si dhe vendimet të marra në komisionet parlamentare, nuk u shpallën në kohë. Veç kësaj, qeveria Kroate nuk e kishte informuar publikun rreth vendimeve të marra për shpërndarjen e buxhetit.

Hendeku i krijuar në rregullore krijoi mundësi për afrimin e partnerëve në procesin e konsultimit si dhe afrimin e publikut në konsultimet e IPA-s - Programi Operacional Mjedisor 2007-2009 nuk u organizua asnjëherë. Megjithatë disa OJQ morrën pjesë në konsultime. OJQ-të Sunce nga Split dhe Zelena Istra nga Pula ishin të pranishëm në konsultimet dhe prezantimet e prioritetin e mbetjeve, ndërsa Zelena Akcija nga Zagrebi, Sunce nga Split dhe Zeleni Osijek nga Osijek morrën pjesë në prezantimet dhe konsultimet mbi prioritetin e ujit.

Konsultime mbi Programin Operacional të Transportit u zhvilluan në 6 mars 2007 dhe 13 qershor 2007, në Ministrinë e Ujërave, Turizmit, Transportit dhe Zhvillimit. Lista e partnerëve që morrën pjesë në dy raundet e konsultimeve përfshinte: sindikatat, universitetet, gazetarë dhe ndër OJQ-të: Zelena Akcija. Konsultimet publike do të duhet të rikryhen nqs. Programet Operacionale do të jenë subjekt për rishikim.

Konsultime mbi Programin Operacional të Zhvillimit të Burimeve Njerëzore u

zhvilluan në Zagreb, 23 mars 2007. Drafti i programit iu prezantua përfaqësuesve të punonjësve, punëdhënësve, qeverisjes lokale si dhe organizatave të shoqërisë civile por nuk është e qartë se cilat nga OJQ-të kanë marrë pjesë në takimin e organizuar. Sidoqoftë, ky Plan Operacional konstaton se përfaqësuesit e shoqërisë civile mund të përzgjidhen si përfaqësues të Komisionit Sektorial Monitorues.

Lista e atyrë që marrën pjesë në këtë konsultim është një përzierje e partnerëve ekonomikë dhe socialë, njësisive të qeverisjes vendore si dhe e institucioneve të sektorëve të veçantë. Megjithatë, asnjë organizatë e shoqërisë civile nuk është në listën e Institucioneve dhe qeverisjes vendore.

Perspektiva

Edhe pse faza e parë e programimit u organizua duke u mbështetur në konsultime, raundi i dytë i programit për periudhën 2011-2013 përfshiu gjithashtu edhe një procedurë për VSM dhe për Planin Operacional për Mjedisin. Në 10 maj 2010, Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Ndërtimit publikoi informacionin zyrtar mbi VSM dhe la 30 ditë afat kohor për dërgimin e komenteve nga ana e publikut. Edhe pse kjo ngjau si një fillim i mbarë, ka kaluar pothuajse një vit dhe Zelena Akcija ende nuk ka marrë asnjë përgjigje mbi komentet e saj ndërkohë që as drafti i Planit Operacional nuk është publikuar.

Korniza ligjore

Në Maqedoni, ekziston një ligj mbi të drejtën e informimit të publikut (i miratuar në 2006), i cili u mundëson qytetarëve të kërkojnë informacion në mënyrë verbale, të shkruar dhe elektronike. Që pas miratimit të këtij ligji, zbatimi i tejk ecur përpara, falë edhe një komisioni të veçantë i cili kujdeset për mirëfunksionimin e tij.

Maqedonia ka miratuar gjithashtu marrëveshjen e Aarhus-it në 1999, e cila i jep mundësinë qytetarëve të kenë informacion, të marrin pjesë në vendim-marrje si dhe të shprehin mendimet e tyre mbi problemet e mjedisit. Në përgjithësi, aspekti juridik i këtij ligji nuk është zbatuar aspak, megjithë përpjekjet e shumta të organizatave të shoqërisë civile për të trajnuar gjyqtarët në problemet e mjedisit. E drejta për informim është arritur deri diku, me përjashtime të vogla që kanë ndodhur herë pas here si pasojë e vendimeve të marra nga qeveria. Për shembull, kur organizatat e mjedisit të shoqërisë civile kërkuan nga Ministria e Ekonomisë informacion mbi ndërtimin e Hidrocentraleve të vogla në Maqedoni, ministria nuk i morri parasysh këto kërkesa. Përmbajtja e këtij projekti u mbajt e fshehtë nga qeveria, e cila ndryshoi komplet natyrën e tij nga publike në biznes qeveritar.

Sipas ligjit mbi mjedisin, qytetarët Maqedonas ushtrojnë të drejtën e informimit dhe atë të përfshirjes në projekte dhe plane të cilat mund të kenë pasoja negative mbi mjedisin. Ligji garanton të drejtën e qytetarëve për informim nëpërmjet dy gazetave të përditshme në vend, nëpërmjet

adresës në internet të Ministrisë së Mjedisit dhe për çdo planifikim apo projekt tjetër që mund të ketë efekte negative për mjedisin. Gjithashtu, qytetarët duhet të informohen rregullisht gjatë hapjes së dokumentave apo gjatë mbajtjes së konsultimeve. Megjithëse ndër vite janë bërë hapa përpara për sa i përket zbatimit të VNM, përfshirja e publikut në vendim-marrje në procedurat e VSM dhe Kontrollit dhe Parandalimit të Integruar të Ndotjes (KPIN) është ende larg standarteve Evropiane

Pjesmarrja publike dhe aksesimi në informacion në nivel projekti

Për sa i përket projektit “Ndërtimi i Korridorit të X”, i cili do të financohet nga Komisioni Evropian dhe bankat Evropiane, mund të thuhet se konsultimet e bëra mbi të në 2008 u kryen në mënyrë të papërshtatshme dhe ishin jo-efikase. Organizatat mjedisore ishin ato që i kërkuan me ngulm Ministrisë së Mjedisit dhe Komisionit Evropian ri-shikimin dhe përsëritjen e këtij procesi. Komisioni Evropian, nga ana e tij, mohoi çdo lloj financimi derisa procedurat e VNM-së të ndryshojnë dhe të kryen në mënyrë të përshtatshme. Mbas marrjes të një sere rekomandimeve mbi organizimin e pjesëmarrjes së publikut, qeveria Maqedonase kreu vitin tjetër ndoshta procesin më të mirë të konsultimeve me publikun në vend. Gjithçka ishte publikuar në kohë, të gjitha dokumentet, të gjitha komentet si dhe përgjigjet dhe komentet e Ministrisë. Mund të thuhet si përfundim, se autoritetet Maqedonase punojnë mirë

kur janë nën presionin e Komisionit Evropian dhe kur financat janë në rrezik.

Për sa i përket procedurave të tjera, një shkelje e rëndë e legjislacionit ndodhi kohët e fundit, kur Ministria e Ekonomisë vendosi të mos kryente procedurën e VSM për Strategjinë e përdorimit të energjisë së rinovueshme deri në 2020. Edhe pse grupet mjedisore u ankuan, dhe Ministria e Mjedisit theksoi se ky Vlerësim Strategjik është absolutisht i detyrueshëm, Ministria e Ekonomisë nuk ndërrmorri përsipër procedurën e megjithatë strategjia u miratua nga Parlamenti. Për më tepër, nuk pati pothuajse asnjë rast të përfshirjes së publikut, gjatë procedurës së KPIN.

NGO involved in partnership consultations

OJQ-të të përfshira në konsultime partneriteti

Aktualisht, organizatat e shoqërisë civile janë të përfshira në hapat e mëposhtme të programimit të IPA-s:

1. Gjatë konsultimeve të Programeve Operative

- Konsultimet për programin operativ për zhvillimin rajonal u krye në 2007, në një mënyrë aspak të kënaqshme, dhe gjatë sezonit të pushimeve nuk u

la as kohë e mjaftueshme (me pak se 30 ditë)

- Organizatat e shoqërisë civile janë ftuar për të komentuar dhe për të marrë pjesë në përgatitjen e asistencës teknike (komponenti I IPA) dhe programi operacional në vitin 2009.

2. Në nivelin e projektit

Organizata nga shoqëria civile dhe qytetarë janë përfshirë në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të dy projekteve infrastrukturore, të financuara nga fondet BE-së.

3. Në komisionet monitoruese

OJQ-të kanë përfaqësuesit e tyre në komisionet monitoruese për zhvillim rajonal dhe rural (IPA komponenti III dhe V), si edhe një përfaqësues në komisionin e shqyrtimit për një projekt të veçantë i fokusuar mbi mbetjet nën Programin Operacional për zhvillimin Rajonal.

Niveli i njohurive i organizatave të shoqërisë civile mbi procesin e programimit dhe në përgjithësi mbi fondet e IPA është i ulët. Ekzistojnë vetëm pak grupe (vetëm ato të mjedisit) të cilat janë në dijeni të procesit dhe që marrin pjesë në konsultime të ndryshme, por përgjithësisht, nuk ka interes të veçantë apo qoftë aftësi nga ana e organizatave për të monitoruar fondet ose projektet.

Kuadri i pëgjithëm ligjor

Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit për periudhën kohore 2004-2009, përcakton të drejtën e çdokujt për të marrë pjesë në proceset e vendim-marrjes.

Ligji mbi Rëndësinë e Aksesit të lirë në Informacionin Publik²¹ rregullon aksesin e lirë të informacionit nga autoritetet publike.

Republika e Serbisë miratoi Marrëveshjen mbi të Drejtën e Informimit, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendim-Marrje dhe Akses në drejtësinë në lidhje me Çështjet Mjedisore (Marrëveshja e Aarhus-it) në 12 maj 2009 dhe u bë pjesë e Marrëveshjes së Aarhus-it në 31 korrik 2009.

Pjesëmarrja publike në vendimmarrje dhe rrjedhimisht edhe në akses në drejtësinë për vendime dhe aktivitete specifike listuar në Artikullin 6 të Konventës së Aarhusit rregullohet nga akti ligjor bazik mbi Ligjin e VNM-se²² dhe nga gjashtë akte nënligjore.

Ligji kyç mbi Planifikimin dhe Ndërtimin është ligji mbi Planifikimi dhe Ndërtimin (Gazeta zyrtare 72/09, 81/09-modif., 64/10 US and 24/11). Ky ligj përcakton qëllimin dhe përmbajtjen e planeve urbane dhe pjesëmarrjen e publikut në lidhje me këto plane. Sipas amendimit të vitit 2011 Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një pjesë integrale vetëm e planifikimit të zonave me funksion të veçantë dhe jo Planeve Hapsinore të Republikës së Serbisë, Planit Rajonal Hapsinor,

²¹ Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 120/2004, 54/2007, 104/2009 dhe 36/2010

²² Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë Nr. 135/04 and 36/09

planet hapsinore të bashkive. Këto të fundit nuk e kanë të detyruar hartimin e VSM-së.

Pjesëmarrja e publikut lidhur me planifikimin urban dhe hapësinor, bëhet gjatë diskutimit me publikun, çka do të thotë që raporti i Vlerësimit Strategjik shikohet në të njëjtën kohë me planin. Veç kësaj, pjesëmarrja e publikut në vendim-marrjen e disa aktiviteteve të veçanta përcaktohet në pjesë të tjera të legjislacionit si Ligji mbi Kontrollin dhe Prandalimin e Integruar të Ndotjes (KPIN).

Ligje të tjera kanë gjithashtu kushte mbi pjesëmarrjen e publikut lidhur me programet dhe projektet zyrtare:

- Ligji mbi Mbrojtjen e Ajrit përcakton se një Program Kombëtar 4-vjeçar për Zvogëlimin Gradual të Emetimit Maksimal Vjetorë të Ndotësve duhet të bëhet i disponueshëm për publikun para miratimit të tij në parlament.
- Ligji mbi ujërat detyron VNM për strategji dhe plan për menaxhimin e ujit si dhe plane të veçanta për menaxhimin e ujit. Publiku ka të drejtë të jetë i mirëinformuar mbi gjëndjen e përgjithshme të ujërave, mbi punën e kryer nga autoritetet përgjegjëse për menaxhimin e ujit si dhe të marrin pjesë në procesin e përgatitjes dhe miratimit të projekteve mbi menaxhimin e ujit si dhe të mbikqyrin zbatimin e tyre.
- Ligji mbi Mbrojtjen e Natyrës përcakton se publiku ka të drejtën e pjesëmarrjes në diskutime mbi

draftin e dokumentit të zonave të mbrojtura si dhe të dokumenteve të tjera mbështetëse – studimi i mbrojtjes me hartat shoqëruese si dhe të drejtën e informimit mbi projektet e menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe projektet mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore.

- Ligji mbi Pyjet parashikon raportin e VSM mbi planin e zhvillimit të pyjeve (planin e zhvillimit të pyjeve në një park kombëtar).

Pjesëmarrja e publikut në vëzhgimin e këtyrë proceseve dhe sigurimi i ecjes së tyre sipas standarteve dhe kushteve të përcaktuara nga VNM nuk ekziston.

Pjesmarrja publike dhe aksesimi në informacionin në nivelin e projektit

Pjesëmarrja publike gjatë procedurës së VNM-së në Serbi është ende në një nivel të ulët, OshC-të dhe publiku i gjerë nuk e përdorin sa duhet këtë procedurë për të dhënë impakt në vendimmarrje. Në anën tjetër OshC-të në Serbi janë nën presion të vazhdueshëm në rastet e inicjativave publike për të ndaluar projekte ose ndryshuar vendndodhjen e tyre. Ka patur raste të ushtrimit të dhunës tek OshC-të gjatë dëgjësive me publikun si në rastin e hidrocentraleve në lumin Lim (për ndërtimin e hidrocentraleve „Brodarevo 1“ dhe „Brodarevo2“) në Gusht 2012, kur aktivistët të ShC donin të shprehnin kundërshtimin e tyre në lidhje me projektin ata u rrahën keq në ambjentet e Ministrisë Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. Kur BE, BERZh, BEI dhe BB janë të përfshira në projekte dëgjësive me publikun janë kryer disi më mirë. Megjithatë edhe në ato raste mendimi i komunitetit nuk merret parasysh. Në rastin e ndërtimit të landfill-it rajonal, inspektorja e mjedisit humbi punën për shkak se

kërkoj pajtueshmëri me procedurën ligjore. Këto raste e shkelin hapur procedurën e VNM-së dhe legjislativonin.

Që prej vitit 2004 kur Serbia miratoi Ligjin e VSM-së, OshC-të janë të pakënaqura me mënyrën se si procedura po zbatohet në vend. Ligji mbi VSM u harmonizua me Direktivën e VSM-së (2001/42/EC) por ka disa probleme me zbatimin. Duhet theksuar se Strategjia Kombëtare e Mbetjeve nuk është vlerësuar nga VSM.

Sipas amendimeve të Ligjit të VSM-së në 2010, Ministria duhet të caktojë një listë se për cilat plane dhe programe VSM është e detyrueshme. Kjo listë nuk është prodhuar ende deri më sot.

OJQ-të përfshira në konsultime partneriteti

Që prej vitit 2010, OJQ-të në Serbi u përfshinë në programimin e IPA dhe në programe të tjera, por nuk u konsideruan si partnerë gjatë përcaktimit të prioritetëve kombëtarë për IPA dhe nuk u përfshinë as në monitorimet e këtyrë fondeve. Në nëntor 2010, OJQ-të ishin të ftuar të linin komentet e tyre mbi “Nevojat e Republikës së Serbisë për Ndihmë Ndërkombëtare 2011-2013” për programimin e fondeve të BE-së. Në këtë konsultim morrën pjesë 67 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat ishin të grupuar në 4 grupe konsultimi.

Në mes të shkurtit procesi i krijimit të proceseve konsultuese të planifikuara mbi programimin e fondeve IPA ka nisur. Fatkeqësisht

filloi vonë për të influencuar prioritetet kombëtare për projektet IPA për 2012. Mekanizmi i përhershëm për konsultim me shoqërinë civile drejtohet nga Zyra Serbe për Integrim Evropian - Departamenti i planifikimit, programimit, monitorimit dhe raportimit për fondet e EU-së dhe asistencës së zhvillimit. Mekanizmi i përhershëm për konsultim me shoqërinë civile përfshin përzgjedhjen e partnerëve të "SEKO" (çka përfshin 3 organizata të shoqërisë civile, nga të cilat një është organizata drejtuese) për secilin nga 8 sektorët e përmendur në programimin e fondeve të BE-së. OJQ-të të cilat janë të organizuara përkrah organizatave të përzgjedhura "SEKO" janë të ftuara për të lënë komentet e tyre mbi projektet e propozuara për vitin 2012,

si dhe mbi Draftin e Programit Operativ për Zhvillim Ekonomik 2012-2013 dhe mbi Draftin e Programit Operativ për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore 2012-2013.

Momentalisht (Tetor 2013), Zyra Serbe për Integrimin Evropian po zhvillon një propozim të ri se si mekanizmi SEKO do të funksionojë në të ardhme.

Në përgjithësi, OJQ-të në Serbi kanë tashmë një informacion më të gjerë rreth programimit të IPA-s, rëndësisë së përfshirjes së shoqërisë civile në të, dhe mundësisë për të ndikuar financimin dhe monitorimin e IPA-s. Por ende roli i tyre në monitorimin e këtyre fondeve dhe projekteve është ende mjaft i vogël.



Mundësitë për përfshirje në programimin e IPA-s në nivel kombëtar

Përgatitja e programeve Operacionale / Sektoriale

Në nivel kombëtar programimi i IPA 2014-2020 fillon në 2013 me përgatitjen e Dokumentit për Strategjinë e secilit prej vendeve përfituese. Ky proces pritet që të përmbyllet në fund të vitit 2013. Më pas pasohet me krijimin e grupeve të punës të sektorëve dhe me përgatitjen e programeve operacionale dhe sektoriale për sektorë të ndryshëm në nivel kombëtar

Afati kohor

Përgatitja e programeve sektoriale dhe operacionale për periudhën 2014-2020 do të vonohet pak dhe do të zhvillohet përgjatë vitit

2014. Organizatat e Shoqërisë Civile dhe aktorë të tjerë jo-shtetëror duhet të luajnë një rol aktiv në proceset konsultuese për përgatitjen dhe miratimin e këtyre programeve

Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të ndërmarrin një hap më tej dhe të kërkojnë përfshirjen e tyre aktuale në grupet sektoriale të krijuar nga qeveria (të cilët në përgjithësi përbëhen vetëm nga përfaqësues të ministrive).Përveç kësaj, sektori i shoqërisë civile duhet të jetë në gjendje për t'u organizuar dhe për të krijuar një mekanizëm funksional, të qëndrueshëm për të realizuar konsulta të vazhdueshme me institucionet e qeverisë lidhur me programimin e fondeve të BE-së në vendin e tyre.



Rekomandime

Për konsultimet publike për programimin:

- Proçesi i programimit duhet të dizajnet herët dhe të bihet dakort mbi të më përpara me të gjithë partnerët e përfshirë në programim. Çdo ndryshim i afateve kohore dhe çdo amendim nga ana e OJQ-ve duhet të konsultohet me të gjithë partnerët e përfshirë.
- Është e këshillueshme që të përcaktojmë kornizën e proçesit në legjislacion në mënyrë që rregullat dhe proçedurat të jenë të zbatueshme.
- Qeveria duhet të sigurojë transparencën jo vetëm të proçesit e të mbledhurit të të dhënave por edhe përpunimit të opinionëve të publikut. Është e këshillueshme që të ketë përgjigje zyrtare ndaj opinionëve.
- Duhet të ketë mjaftueshëm kohë brenda proçesit që të dorëzohen komente për dokumentet draft, (të paktën dy javë ose më shumë, në varësi të sasisë së dokumentacionit).
- Dokumentet për takime apo grupe pune dhe komisioni duhet që të qarkullojnë 10 ditë pune më parë në mënyrë që të ketë mjaftueshëm kohë për tu përgatitur.
- OJQ-të duhet që të ndjekin aktivisht draftimin e dokumenteve të programimit në nivel rajonal dhe kombëtar. Është e këshillueshme që të zhvillohet një sistem uniform me delegatët pjesmarrës të OJQ-ve në grupet e punës ose komisionet.
- OShC-të duhet të krijojnë partneritete strategjike dhe të organizohen në koalicionë apo platforma.
- OShC-të duhet të pajisin me informacione cilësore si autoritetet kombëtare, po ashtu edhe Komisionin Evropian.
- OJQ-të duhet të sigurojnë alokimin e resurseve financiare dhe të burimeve njerëzore në mënyrë që të marrin pjesë në programim.
- Ekspertë kompetentë duhet të asistojnë të gjithë proçesin e përdorimit të fondeve, duke mbështetur dhe dhënë kontributin e tyre që pjesmarrja e aktorëve të jetë sa më efektive.
- Për punën e Komisioneve Monitoruese
- Është e këshillueshme që OJQ-të të zhvillojnë një sistem uniform për dërgimin e pjesmarrësve në Komisionet Monitoruese dhe Drejtuese.
- OJQ duhet të insistojnë për të patur të drejta të plota votimi nqs. nuk e kanë këtë të drejtë.
- OJQ duhet të jenë të përgatitur të dinë se fluksi i informacionit do të jetë i çrregullt dhe koha e vënë në dispozicion për konsultime do të jetë e shkurtër. Për të evituar këtë OJQ-të mund të konsiderojnë përgatitjen e kërkesave kryesore që më parë.

- OJQ duhet të sigurojnë që të alokojnë resurset financiare dhe

të burimeve njerëzore në mënyrë që të marrin pjesë në punën e komisioneve..



Lidhje të dobishme

Informacion i përgjithshëm:

http://ec.europa.eu/enlargement/how-does-it-work/financial-assistance/index_en.htm

DPSHl: http://ec.europa.eu/enlargement/how-does-it-work/financial-assistance/planning-ipa_en.htm#mipd

Dokumentat dhe raportet më të rëndësishme:

http://ec.europa.eu/enlargement/press_corner/key-documents/index_en.htm

Europa “kush është kush”, gjej personin e duhur në institucionin e duhur:

<http://europa.eu/whoiswho/whoiswho.html>

Materiale informuese:

Le të flasim për IPA - Instrumenti i Para-aderimit. Një udhëzues për organizatat e shoqërisë civile, 2011

Varianti në Shqip: <http://bankwatch.org/documents/IPA-toolkit-Albanian.pdf>

Versioni në Maqedonisht: <http://bankwatch.org/documents/IPA-toolkit-Macedonian.pdf>

Versioni në Serbisht: <http://bankwatch.org/documents/IPA-toolkit-Serbian.pdf>

Buxheti i BE-së për të gjithë - Udhëzues për popullin programimit financiar të Bashkimit Europian, 2012 <http://bankwatch.org/sites/default/files/EU-peoplesguide.pdf>

www.bankwatch.org



2013

